



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 39 regjistër (JR)
Datë 07.09.2022

Nr. 54 i vendimit
Datë 16.07.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 16.07.2025, ditën e mërkurë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 39 (JR), datë 07.09.2022, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike, Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 538, datë 07.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Alvora.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (*në vijim “ligji nr. 84/2016”*), analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike, e cila kërkoi ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 538, datë 07.06.2022, dhe pas kalimit procedural te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili në bisedimet përfundimtare kërkoi ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi, pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe pasi dëgjoji parashtrimet dhe analizoi kërkimet në bisedimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi lënien në

fuqi të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe e bisedoi atë në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi,

VËREN:

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Alvora, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim "Komisioni"*), për arsye se ushtronte detyrën e prokurores në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë¹.
2. Procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Alvora, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, Komisioni administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim "ILDKPKI"*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim "DSIK"*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*në vijim "KLGj"*), nga të cilat rezultoi se:

2.1. ILDKPKI-ja², bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të "*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Elona Alvora*", referoi se:

- (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

2.2. DSIK-ja³, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, konstatoi *përshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës.

2.3. KLP-ja⁴, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Pas kryerjes së procedurës administrative, me vendimin nr. 538, datë 07.06.2022, Komisioni e konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit, duke arsyetuar për secilin kriter se: (i) ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në kreun IV të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (iii) është vlerësuar

¹ Aktualisht, subjekti i rivlerësimit është prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

² Shkresë nr. {***} prot., datë 30.01.2018, "Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Elona Alvora".

³ Shkresë nr. {***} prot., datë 02.11.2017, "Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Elona A. Alvora", i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZh-së nr. {***}, datë 27.10.2021.

⁴ Shkresë nr. {***} prot., datë 18.05.2021, "Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Elona Alvora".

e aftë profesionale, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit të sipërcituar të Komisionit, ka ushtruar ankim Komisionerja Publike, znj. Irena Nino, e cila kërkon nga Kolegji, në mënyrë alternative ndryshimin *ose* lënien në fuqi të vendimit të Komisionit. Shkaqet e ankimit lidhen vetëm me aspektin e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit, bazuar në nenet 71-73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”). Komisionerja Publike parashtron se hetimi administrativ nuk ka qenë i plotë dhe shpjegimet e provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk janë bindëse e të mjaftueshme për të rrëzuar barrën e provës, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara.

4.1. Sipas Komisioneres Publike, në disa raste, pavarësisht detyrimit për të respektuar urdhërimet e qarta dhe logjike të gjykatave, subjekti i rivlerësimit nuk ka realizuar veprimet hetimore në kohë, duke sjellë edhe cenim të të drejtave të palëve të përfshira në proces apo të palëve që kishin interes mbi ecurinë dhe përfundimet e pritshme prej tij, brenda afateve të arsyeshme, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”).

4.2. Komisionerja Publike e çmon të nevojshëm çeljen e hetimit administrativ dhe rivlerësimin e rastit, për të hetuar nëse veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit, përbëjnë mangësi profesionale dhe/ose model pune të tillë, që sjell vonesa të tepruara dhe mungesë efektiviteti në procedime jokomplekse. Sipas saj, hetimi i Komisionit nuk ka qenë i plotë për të pasjellë krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, në kuptim të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Pretendimet e Komisioneres Publike u përqendruan në elemente që lidhen kryesisht me zbatim të afateve të hetimeve, zbatim të urdhërimeve të gjykatës/vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe Komisioni nuk duhet të kishte dërguar për inspektim në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) çështjet që dëshmojnë praninë e mangësive profesionale të subjektit apo raste që gjejnë zbatim dhe kanë nevojë për hetim në kuadër të procesit të rivlerësimit, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Shkaqet e ankimit për secilën çështje jepen në mënyrë të detajuar në analizën e Kolegjit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën

pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

6. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

7. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Institucioni i Komisionerëve Publikë kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 538, datë 07.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Alvora, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.

7.1. Në seancën gjyqësore publike të datës 29.05.2025, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural të ankuesit, nga Komisionerja Publike Irena Nino, te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Altin Dumani, i cili u përfaqësua në gjykim nga z. Adnan Xholi, sipas tagrave të përfaqësimit të përcaktuara në autorizimin nr. {***} prot., datë 23.05.2025.

7.2. Në parashtrimet gjatë seancës gjyqësore publike të datës 29.05.2025, në Kolegji, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi, iu qëndroi të gjitha shkaqeve të parashtruara nga Komisionerja Publike, në ankim, duke kërkuar, gjithashtu, në mënyrë alternative ndryshimin e vendimit të Komisionit *ose* lënien në fuqi të tij. Ai theksoi nevojën e riçeljes së hetimit gjyqësor dhe rivlerësimit të rastit nëse veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë mangësi profesionale apo model pune të tillë që sjell vonesa të tepruara dhe mungesë efektiviteti në procedime jokomplekse.

7.3. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj me shkrim, iu qëndroi shpjegimeve të dhëna në Komision, duke pretenduar se ka pasur ngarkesë/volum në punë që lidhet me mungesë të burimeve njerëzore/prokurorëve, ndërsa kërkoi përfundimisht që Kolegji të shprehej objektiv në gjykim.

7.4. Pasi dëgjoi palët në seancën e datës 29.05.2025, për efekt të shqyrtimit të çështjes në Kolegji me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues vendosi të riçelë hetimin gjyqësor dhe të kërkojë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe Prokurorisë pranë kësaj gjykate, administrimin e disa fashikujve penalë, pjesë e ankimit të Komisioneres Publike, përfaqësuar në këtë gjykim nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

7.5. Këta dy institucione dërguan informacionin e kërkuar pranë Kolegjit⁵. Me këtë informacion u njohën edhe palët në proces. Pas njohjes me aktet, në seancën e datës 24.06.2025, palët shprehën

⁵ Konkretisht aktet u dërguan nëpërmjet shkresave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 12.06.2025, "Dërgim aktesh" dhe nr. {***} prot., datë 16.06.2025, "Kthim përgjigje", si dhe shkresat e Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nr. {***} prot., datë 13.06.2025, "Dërgim aktesh" dhe nr. {***} prot., datë 19.06.2025, "Dërgim aktesh".

njohjen me aktet/fashikujt e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë dhe Prokuroria pranë kësaj Gjykate dhe pranimin e tyre në cilësinë e provës. Në këtë seancë u zhvillua edhe debati gjyqësor. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deklaroi se evidentohen mangësi profesionale gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet e saj lidhur me gjetjet e referuara nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe mbajti qëndrim për secilin rast. Trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mbyllë hetimin gjyqësor të çështjes dhe bisedimet përfundimtare u caktuan për t'u zhvilluar në datën 09.07.2025.

7.6. Në bisedimet përfundimtare, palët paraqitën konkluzionet e tyre me shkrim. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme konkludoi se mangësitë e verifikuara *nuk* duket të kenë cenuar ushtrimin e ndjekjes penale në emër të interesave shtetërore, sa kohë procedimet penale përkatëse i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor dhe veprimet hetimore në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë janë kryer duke plotësuar detyrat e lëna e duke vijuar ushtrimin e ndjekës nën mbikëqyrjen gjyqësore. Sipas përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, për subjektin e rivlerësimit, evidentohen mangësi në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas indikatorëve të përcaktuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të cilat nuk kanë cenuar veprimtarinë hetimore dhe mund të korrigjohen nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Përfundimisht, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i kërkoi Kolegjit ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 538, datë 07.06.2022, pezullimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit të ofruar nga Shkolla e Magjistraturës.

7.7. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e saj lidhur me rrethanat e çështjeve penale të përfshira në ankim dhe përsëriti kërkesën për të mos pranuar ankimin lidhur me dy çështjet e transferuara pranë ILD-së. Lidhur me çështjet e tjera, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka pasur aftësinë të ndërmarrë veprime hetimore të logjikshme, në zbatim të ligjit procedural dhe se mangësitë e vërejtura nuk janë të tilla që të kenë shënuar problematika në veprimtarinë hetimore. Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 538, datë 07.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që e ka konfirmuar atë në detyrë.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit

8. Në përfundim të procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegji dhe pas analizës shteruese, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se vendimi objekt shqyrtimi i Komisionit duhet të *ndryshohet*. Subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi profesionale të një mënyre gjykimi, pune e sjellje, që nuk pajtohen me pozicionin e saj, e që e bën të nevojshme caktimin e masës disiplinore të *pezullimit*, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur *programin e edukimit* në Shkollën e Magjistraturës. Ky konkluzion bazohet në vlerësimin e shkaqeve të ankimit dhe akteve në fashikull, sikurse edhe ato të administruara gjatë procesit gjyqësor në Kolegji, nën dritën e kriterëve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve 71 -73 të ligjit nr. 96/2016. Në këtë analizë u përfshinë edhe dy çështjet që u transferuan nga Komisioni për inspektim pranë ILD-së, në kushtet që pretendimet e subjektit, që ato të mos i nënshtrohen vlerësimit, u çmuan të pabazuara.

8.1. Përfundimi i mësipërm i trupit gjykues të Kolegjit mbajti në konsideratë që në të shtatë (7) çështjet e parashtruara për vlerësim nëpërmjet shkaqeve të ankimit, të analizuara së bashku, subjekti i rivlerësimit paraqet problematika që konsistojnë, ndër të tjera, në: (i) *moszbatimin* e përsëritur të

urdhërimeve të gjykatës, për të kryer veprime konkrete e specifike hetimore që mund ta kishin strukturuar qartë e arsyeshëm drejtimin e hetimit dhe krijuar një panoramë objektive, në funksion të respektimit të të drejtave të palëve; (ii) nuk kryen *asnjë* veprim hetimor ose kryen veprime hetimore tejet të mangëta, edhe në kufijtë e shpërfilljes së problematikës së referuar nga individët e dëmtuar apo referuar në materialin kallëzues, ndonëse aktet sugjerojnë ndryshe edhe në pamje të parë; (iii) nuk ka kryer cilësim të saktë të veprës penale në disa raste, e, duke kryer veprime procedurale të pambështetura e në moszbatim të udhëzimeve të gjykatës; (iv) ka tejzgjatur afatet e hetimeve në mënyrë të pajustificuar, si dhe nuk ka respektuar afatet e caktuara nga gjykatat për kryerjen e veprimeve hetimore; dhe (v) nuk ka respektuar detyrimin për të treguar sjellje profesionale gjatë ushtrimit të detyrës, në kushtet kur është larguar edhe nga seanca gjyqësore.

8.2. Trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi këto sjellje në kontekstin e detyrimeve që mbartte subjekti si prokurore në zbatim të dispozitave procedurale penale që normojnë afatet e hetimeve paraprake dhe pushimin e akuzës/çështjes, nën dritën e nënindikatorëve të parashikuar nga nenet 71-74 të ligjit nr. 96/2016, për aftësinë e subjektit për të ndërmarrë veprime hetimore, dhe parimeve themelore të funksionimit të prokurorisë, për të respektuar procedimin e drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore dhe interesin publik. Nga analiza e kryer në Kolegji, nën dritën e tërësisë së këtyre parimeve, trupi gjykues vëren se, në të gjitha çështjet e analizuara, gjykatat kanë urdhëruar kthimin për hetim të mëtejshëm, në secilin prej tyre [rasteve], më së paku dy herë, për shkak të mangësive në hetime.

8.3. Konkretisht, në 4 (katër) çështje⁶, vendimi i subjektit për mosfillim është prishur nga gjykata e shkallës së parë dhe në asnjë rast nuk është pranuar ankimi i subjektit nga gjykata e apelit, për shkak se u konstatua mungesë hetimesh. Për 2 (dy) rastet e tjera, subjekti vendosi pushimin e çështjes⁷, që gjithashtu u vlerësua i pabazuar dhe u prish nga gjykatat. *Së fundmi*, në njërin rast⁸, pasi iu caktua çështja, subjekti vendosi pushimin e saj vetëm pas 27 muajsh [dy vjet e tre muaj në total]. Ndonëse në disa prej çështjeve gjykatat kanë konkluduar eventualisht në linjë me vendimmarrjen paraprake të subjektit, ky rezultat ka qenë pasojë e një hetimi të plotësuar për vërtetimin e faktit të vënë në diskutim, siç ishte rasti i procedimit penal nr. {***/2015 [nga familja P.] dhe i procedimit penal nr. {***/2017 [nga G. S.], ndërsa në disa raste të tjera u vendos sipas vendimmarrjes paraprake të subjektit, por me një arsytim të ndryshëm, siç ishte rasti i procedimit penal nr. {***/2020 [nga F. H.] dhe i procedimit penal nr. {***/2017 [nga M. Ç.]

8.4. Problematikat e sipërpërmbledhura tregojnë cilësi të papranueshme në punë dhe gjykim të dobët. Subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave dhe nuk është efektive. Këto aspekte e kualifikojnë atë [subjektin e rivlerësimit] me *mangësi*, nën dritën e përcaktimit të nenit 44, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Në këtë përfundim, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje si aspekte me rëndësi konstatimin e mungesës së hetimeve efikase, referuar thujt në çdo rast nga gjykatat, sikurse edhe zvarritjet e proceseve duke i dhënë përparësi apo përdorur kohën për të provuar një qëndrim të sajin dhe jo dedikuar nevojës për të zbuluar fakte e rrethana në dobi të çështjes, mbrojtjes së interesit publik e të drejtave të palëve. Në këtë dritë, trupi gjykues analizoi edhe disa raste në të cilat subjekti ka paraqitur ankime që rezultojnë edhe të

⁶ (i) Kallëzimi penal nr. {***/2020, i bashkuar me procedimin nr. {***/2021; (ii) kallëzimi penal nr. {***/2017; (iii) kallëzimi penal nr. {***/2015; dhe (iv) procedimi penal nr. {***/2020.

⁷ Procedimi penal nr. {***/2017 dhe procedimi penal nr. {***/2015.

⁸ Procedimi penal nr. {***/2015.

pambështetura në ligj, në ndonjë rast, e nuk janë pasojë e vlerësimit e reflektimit të të gjithë rrethanave kontrolluese të çështjes specifike.

8.5. Po ashtu, me rëndësi për trupin gjykues e në plotësim të kësaj panorame mjaftueshëm për klasifikimin e sipërreferuar të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, u vlerësuan edhe rrethana të tjera që rezultojnë nga çështjet si mosshënimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistër edhe kur nga aktet rezulton qartësisht se fakti i atribuohet një personi konkret e me identitet të plotë, moszbatimi i përsëritur i urdhërimeve të gjykatës, mungesa e analizës në arsyetimin e urdhrave apo largimi nga seanca gjyqësore në zhvillim në mënyrë demonstrative e duke shkelur rregullat e etikës profesionale në kontekstin e respektimit të solemnitetit të gjykatës. Në mënyrë të detajuar për secilën çështje, analiza e trupit gjykues paraqitet si vijon.

9. *Kallëzimet penale nr. {***/2020 dhe nr. {***/2021*

9.1. Denoncuesi i ka paraqitur dy denoncime në Komision, për dijeni edhe ONM-së në datat 03.03.2022 dhe 20.05.2022. Denoncuesi/përfaqësues i shoqërisë “{***}” ShPK ka denoncuar subjektin edhe në ILD edhe në Prokurorinë e Përgjithshme, duke kërkuar kryerjen e inspektimit për të nxjerrë në pah shkeljet *flagrante* të subjektit. *Denoncuesi* ngre pretendime që lidhen me hetimet e subjektit, që pretendohet se janë kryer me qëllim favorizimin i firmave të tjera që importojnë produktin e regjistruar si markë e në pronësi industriale të kësaj shoqërie. Komisioni ka hetuar për këtë denoncim dhe i ka kaluar subjektit edhe barrë prove, por nuk ka mbajtur qëndrim në vendim.

9.2. Në ankim, Komisionerja Publike kërkon hetim për të vlerësuar nëse, në këtë procedim penal të filluar në muajin korrik 2020 e deri *aktualisht*, veprimet e subjektit janë në përmbushje të standardeve të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket aftësisë për të hetuar, për të nxjerrë urdhra dhe marrë vendime. Gjithashtu, referuar akteve në dosje të Komisionit, sipas Komisioneres Publike, vërehen zvarritje kohore të pajustificueshme për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Këto vonesa, për shkak të llojit të veprës penale *kundërvajtje penale*, mund të çojnë edhe në parashkrimin e ndjekjes penale. Po ashtu, Komisionerja referon edhe që për të njëjtën vepër penale ka paraqitur kallëzim edhe z. R. M. [administratori dhe pronari i shoqërisë “{***}” ShPK] më 25.05.2021 dhe subjekti mori po ashtu vendim mosfillimi. Në bisedimet përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të SPAK-ut u shpreh se nga analiza e veprimeve të kryera nga subjekti evidentohen mangësi të kriterit profesional, sipas nënindikatorëve të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 dhe që veprime procedurale të subjektit nëpërmjet ankimeve, që kanë përfshirë harkun kohor thuhetse dyvjeçar deri në ditën kur ajo ka regjistruar procedimin penal, mund të sjellin eventualitetin e parashkrimit të ndjekjes penale në kushtet që ajo ka disponuar për të hetuar për një kundërvajtje penale.

9.3. Në rezultatet e hetimit, Komisioni konstatoi veprime dhe mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, të cilat ndikuan në zvarritjen e pajustificuar të hetimit të çështjes. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se subjekti rezultoi të ketë kryer verifikimet e nevojshme vetëm pas orientimit dhe urdhërimit të gjykatës për kryerjen e tyre çka e bën sjelljen profesionale e saj me mangësi dhe i kaloi barrën e provës.

9.4. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti u shpreh se vendosi mosfillimin e procedimit penal, pasi konstatoi se ishte kryer zhdoganimi dhe ambalazhi/paketimi i produktit ishte i ndryshëm nga ai që mbrohej nga kallëzuesi. Sipas saj, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë linte pa përgjigje pyetjet e ngritura prej saj në ankim, mbi përgjegjësinë e autoriteteve doganore që lejuan hyrjen e mallit. Nuk

ka respektuar afatet, pasi ka qenë e sëmure për dy javë dhe, pasi u kthye në detyrë, vendosi regjistrimin e procedimit penal, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit. Subjekti u shpreh se *vijon të mendojë* se saktësimi i rolit të autoriteteve doganore është i domosdoshëm për t'u kuptuar që prokuroria dhe hetimi penal nuk po përdoren si barrierë për të nxjerrë konkurrentët nga tregu apo për të penguar (frikësuar) futjen e konkurrentëve të rinj në produktet zëvendësuese. Për sa kohë çështjet e ngritura në ankim ishin tërësisht ligjore, sqarimi i tyre duhet të bëhet nga gjykata/gjykata e hetimit paraprak, ndërkohë që çështja *është* në proces hetimi. Komisioni nuk e bëri pjesë të vendimit këtë çështje.

9.5. Në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti i qëndroi shpjegimeve të dhëna në hetimin e kryer nga Komisioni dhe potencoi se pjesërisht vonesa ka qenë pasojë e qenies sëmure për dy javë dhe vonesave të tjera që nuk janë shkaktuar prej saj. Po ashtu, në kushtet që gjykata nuk i dha përgjigje pyetjeve ligjore dhe që nuk ishin marrë në përgjegjësi punonjësit e doganës që kanë lejuar zhdoganimin, ajo ishte e detyruar të ankohej kundër atij vendimi gjyqësor. Sipas subjektit, pretendimet në kallëzim nuk kanë të bëjnë me produktin, por me ekskluzivitetin e tregtimit të produktit “{***}”. Shkelja e ekskluzivitetit të tregtimit, e pashoqëruar me cenim të elementeve të mbrojtur të markës, në kushtet që pretendimet nuk janë për produktin, nuk sjell përgjegjësi penale në kuptim të nenit 149/a të Kodit Penal. Produkti i sekuestruar është blerë nga prodhuesi italian, që sipas vlerësimit të subjektit, përmbush edhe kushtin e pëlqimit të pronarit të markës. Gjithashtu, në lidhje me pretendimet ndaj punonjësve të doganës, për shkak se cilësimi/emërtimi i produktit nuk mbrohet nga regjistrimi i markës, ndjekja e procedurave doganore dhe vjelja e detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit në zhdoganim nuk përbën veprim të kundërligjshëm. Subjekti ka vlerësuar se mungon pasoja në kuptim të ligjit penal, pasi nuk konsiderohet e tillë vetëm shkelja e ekskluzivitetit të tregtimit e pashoqëruar me elemente të tjera.

9.6. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse elaboruar në mënyrë të përmbledhur më sipër, vëren se argumentet e parashtruara nga Komisionerja Publike dhe Drejtuesi i SPAK-ut janë të bazuara. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore të mjaftueshme, ka zvarritur procesin duke shkaktuar zgjatjen dhe mosdhënien zgjidhjen e konfliktit të potencuar nga palët me ndërmarrje ankimesh dhe mosveprime në kohë, duke pasqyruar si pasojë efektivisht mosdhënien e një zgjidhjeje nga viti 2020 deri në vitin 2024, për interesat ekonomike të potencuara nga palët e dëmtuara. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

9.7. Nga të dhënat e denoncimeve dhe aktet në fashikujt e plotësuar gjatë hetimit në Kolegj, rezulton se shoqëria tregtare “{***}” ShPK ka të drejtën e markës “{***}”, për një insekticid, regjistruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, që gëzon gjithashtu mbrojtjen doganore të lëshuar po nga kjo drejtori. Nga denoncimet e dy individëve, A. dhe R. M. përkatësisht në vitin 2020 dhe 2021, lidhur me dy kallëzime penale për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale, rezulton se subjekti ka marrë vendime mosfillimi procedimi penal për të dy kallëzimet e depozituara, me të njëjtin objekt. Vendimet e marra prej saj janë shfuqizuar nga gjykatat pas një sërë veprimesh procedurale që kanë vazhduar edhe në harkun kohor të viteve 2022-2024.

9.8. Konkretisht, nga faktet e pretenduara rezulton se produkti industrial për të cilin ka ushtruar kallëzim denoncuesi prodhohet në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria “{***}” ShPK në datën 23.07.2020 ka depozituar kallëzim ndaj shoqërisë “{***}” ShPK në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, për shkak se kjo e fundit, nëpërmjet Italisë ka importuar në Shqipëri produktin “{***}” insekticid, i cili ishte regjistruar si markë e shoqërisë “{***}” ShPK. Sipas denoncuesit, shoqëria “{***}” ShPK ka ekskluzivitetin për të tregtuar këtë markë në Shqipëri. Në vitin 2021, në Gjykatën

e Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar edhe një çështje tjetër me kallëzues të njëjtin individ, z. R. M., kundër shoqërisë “{***}” ShPK, për veprën penale të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale, për të njëjtin produkt.

9.9. Kallëzimi i parë u regjistrua në datën 27.07.2020 dhe iu shortua subjektit. Në datën 11.09.2020, subjekti vendosi *mosfillimin e procedimit penal*, me arsyetimin se nuk plotësohen kushtet e nenit 149/a/1⁹ të Kodit Penal, pasi faktet e kallëzuar nuk përmbajnë elemente të figurës së ndonjë vepre penale. Sipas vlerësimit të subjektit, referuar certifikatës së regjistrimit, markës “{***}” i mbrohen ngjyrat [e kuqe, e verdhë, e zezë, blu e bardhë] dhe përjashtohet nga mbrojtja produkti i prodhuar nga shoqëria italiane [{***} srl].

9.10. Ndaj vendimit të mësipërm të subjektit, kallëzuesi ushtroi ankim. Gjykata Rrethit Gjyqësor Vlorë vendosi të prishë vendimin e mosfillimit dhe urdhëroi prokurorinë për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, duke marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale nëse produkti i tregtuar nga kompanitë e kallëzuar është markë e mbrojtur dhe nëse po, cila është shoqëria që e ka mbrojtur atë. Gjithashtu, gjykata ka çmuar se prokuroria bëri një interpretim të gabuar lidhur me pronarin që ka dhënë pëlqimin, parashikuar në nenin 149/a/1 të Kodit Penal. Dhënia e pëlqimit i referohet një akordi me qëllim importimin për arsye tregtimi. Për të konkluduar lidhur me pëlqimin, prokuroria duhet të hetojë. Këtë vendim e ankimoi subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, me argumentin se nuk ka nevojë për hetim, pasi dokumentacioni pranë Drejtorisë së Markave dhe Patentave i është vënë në dispozicion nga kallëzuesi. Sipas subjektit, nuk është detyrë e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale të konstatojë nëse produkti italian i tregtuar mbrohet. Për shkak se dallimi mes produktit me ngjyra që merret në mbrojtje është i dukshëm, veprimi i urdhëruar nga gjykata bëhet i panevojshëm. Subjekti paraqiti edhe dy pyetje¹⁰ për Gjykatën e Apelit Vlorë.

9.11. Nga aktet në fashikuj rezulton se prokurori pranë Gjykatës së Apelit Vlorë deklaroi heqjen dorë nga ankimi. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 17.03.2021, vendosi mospranimin e ankimit.

9.12. Komisionerja Publike ka kërkuar t’i nënshtrohet hetimit edhe ky procedim penal me nr. {***/2021, i cili lidhet me kallëzimin që z. R. M. ka paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 26.05.2021, ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, për veprën penale të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale. Me të njëjtin arsyetim, sikurse në kallëzimin nr. {***/2020, subjekti ka vendosur mosfillimin edhe për procedimin e vitit 2021. Gjatë hetimit administrativ në

⁹“ Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i: a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës; b) produktit që mbrohet nga një dizeno industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjës industriale; c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare; ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik; të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

¹⁰ Pyetjet drejtuar Gjykatës së Apelit nga subjekti janë: “[a] A do të konsiderohet vepër penale shkelja e ekskluzivitetit të tregtimit që nuk shoqërohet me cenim të elementeve të mbrojtura të markës meqenëse edhe vetë kallëzuesi nuk ka pretendime për produktin por vetëm për cenimin e ekskluzivitetit që ai pretendon se ka në tregtimin e produktit me logon “{***}”, sepse përveç produktit me ngjyra të tij, tregtohen nga subjekte të tjera i njëjti produkt por me ngjyra të tjera? (b) Nëse po, a passjell përgjegjësi penale “zhdoganimi” i produkteve me ngjyra të pambrojtura me arsyetimin se produkti me ngjyra të mbrojtura është i vetmi që duhet të tregtohet në R. Sh?”.

Komision, referuar shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kjo çështje ishte në shqyrtim në Gjykatën e Apelit pas ankimit të subjektit¹¹.

9.13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 22.10.2021, pranoi ankimin e kallëzuesit dhe shfuqizoi vendimin e subjektit, duke urdhëruar prokurorinë të kryejë veprimet hetimore. Gjykata ka arsyetuar se pushimi i çështjes për shkak të rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit dhe vlerësimi i prokurorit se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, është i gabuar dhe në kundërshtim me ligjin, sipas nenit 149/a të Kodit Penal. Gjykata, po ashtu, ka argumentuar se që fakti nuk ekziston mund të konkludohet vetëm pasi të jenë kryer hetimet. Prokuroria duhet të kishte verifikuar nëse produkti është markë e mbrojtur duke marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, më datë 17.05.2022, me të njëjtin arsyetim. Subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale dhe për bashkim të dy procedimeve penale më 13.10.2022. Gjatë harkut kohor 2023-2024¹², janë kryer veprime hetimore nga oficerë të policisë gjyqësore dhe marrë të dhëna nga persona që kanë dijeni për veprën penale.

9.14. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se meqenëse subjekti ka mbajtur një qëndrim përfundimtar për këtë çështje, nuk gjen zbatim ndalimi për t'iu nënshtruar rivlerësimit, në kuptim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Në rastin objekt shqyrtimi, çështja është në hetim nga një prokuror tjetër në zbatim të urdhërimeve të gjykatës dhe, mbi të gjitha, subjekti ka mbajtur qëndrime të cilat i ka mbrojtur edhe gjatë ankimeve në Gjykatën e Apelit.

9.15. Së dyti, nga analiza e kohëzgjatjes rezulton se mes kallëzimeve dhe momentit kur subjekti ka marrë vendim për fillimin e hetimit kanë kaluar përkatësisht 18 muaj dhe 11 muaj. Konkretisht, kallëzimi i parë është depozituar në 27 korrik 2020 dhe subjekti përfundimisht ka regjistruar çështjen vetëm në 26 janar 2022, ndërsa kallëzimi i dytë është depozituar në nëntor 2021 e çështja është regjistruar në 13 tetor 2022. Pavarësisht se në këto harqe kohore ka periudha ku përfshihen ngjarje përtej kontrollit të subjektit, fakti që individët të drejtat e të cilëve pretendohen të cenuara nuk kanë gjetur një përgjigje nga prokuroria për periudha tejet të zgjatura, pavarësisht nga orientimi i gjykatave, që hetimi ishte i papërfunduar edhe në vitet 2023-2024 dhe, mbi të gjitha, që subjekti refuzoi të kryente veprime bazike hetimore që nevojiteshin për të konfirmuar bindjen e saj edhe në tetor 2021¹³, ndonëse dy gjykata të dy niveleve i kishin mundësuar më së paku një interpretim ligjor që hidhte dritë mbi të kundërtën e vendimmarrjes së saj, që në mars 2021¹⁴, tregon më së paku mungesë aftësie për t'u orientuar në shërbim të interesit publik dhe mbajtur në fokus parimet e ekonomisë gjyqësore që drejtësia e vonuar krijon premisa për drejtësi të munguar.

¹¹ Të dhënat lidhur me procedimin nr. {***/2021 u administruan nga aktet e përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me shkresën e datës 12.06.2025. Për këtë procedim janë përcjellë akte edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me shkresën e datës 13.06.2025.

¹² Në dosje administrohet edhe kërkesa për informacion drejtuar Degës së Doganës Vlorë nga Prokuroria Vlorë [një prokuror tjetër], e datës 23.11.2023, për listë të mallrave të mbrojtura, dhe praktikën për produktet e mbrojtura, sikurse edhe kërkesat datë 18.05.2023 dhe 20.12.2023 për informacion për markat e mbrojtura drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Në dosje gjenden edhe 4 procesverbale të vitit 2024, të marrjes së dokumenteve dhe të pyetjes së personave që kanë dijeni për rrethanat e veprës penale.

¹³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 22.10.2021 [me vendimin nr. {***/}] ka vendosur shfuqizimin e vendimit të subjektit për mosfillim të procedimit penal referuar kallëzimit nr. {***/2021. Edhe këtë vendim, subjekti e ka ankimuar në Gjykatën e Apelit. Në mars 2022 kjo çështje ishte ende e pashqyrtuar nga Gjykata e Apelit.

¹⁴ Më datë 02.12.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë shfuqizoi vendimin e subjektit për mosfillim të procedimit penal referuar kallëzimit penal nr. {***/2020 duke urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore. Gjykata e Apelit Vlorë, pas ankimit të subjektit, në 17.03.2021 ka vendosur mospranim të ankimit të saj.

9.16. Konkretisht, nga aktet rezulton që, për shkak të insistimit të subjektit për të mos regjistruar procedimin penal, gjykatat janë angazhuar katër herë, për një problem dhe objekt të njëjtë – gjykuar nga fakti që eventualisht, në tetor 2022 procedimet penale të derivuara nga dy kallëzimet janë bashkuar më 13.10.2022 – dhe si pasojë e zvarritjes, personat që kanë dijeni për veprën penale janë pyetur nga oficerët e policisë gjyqësore vetëm gjatë viteve 2023-2024. Aspekti kohor merr rëndësi të veçantë sidomos në kushtet që regjistrimi ishte kryer për një kundërvajtje penale, parashkrimi i ndjekjes penale të së cilës ka kohëzgjatje deri në dy vjet¹⁵.

9.17. Në rastin konkret, në kushtet që subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit pa u investuar as në verifikimin e të dhënave bazike nëpërmjet ndërveprimit me institucionin e specializuar, Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për të identifikuar nëse produkti i tregtuar nga kompanitë e kallëzuara është markë e mbrojtur dhe nëse kishte një person juridik të regjistruar që gëzonte mbrojtjen e saj. Në këto kushte dhe pasi subjekti ishte urdhëruar nga gjykata të kryente veprimet minimale hetimore dhe në një këndvështrim të ndryshëm nga ai origjinal i saj¹⁶, si parakusht për të arsyetuar nëse rrethanat e lejonin fillimin e procedimit penal apo nëse kishte vend të konstatohej, sipas gremës “ç” të pikës 1 të nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale¹⁷, subjekti ka insistuar me të njëjtin interpretim edhe për kallëzimin e dytë.

9.18. Nga verifikimi në faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, marka “{***}”, me nr. aplikimi {***}, është e regjistruar në emër të denoncuesit [z. R. M.]. Në shpjegimet e saj në procesin e rivlerësimit, sikurse edhe në vendimet e marra, është e paqartë përse subjekti shprehet se është Gjykata e Apelit që duhet të sqarojë rolin e administratës doganore, në kushtet që përgjegjësia për të kryer hetim dhe identifikimi i veprave penale dhe autorëve të tyre është e prokurorisë. Në këtë kuptim, pyetjeve që subjekti ngriti për Gjykatën e Apelit, duhet t’iu kishte dhënë përgjigje në kuadër të hetimeve që po kryente.

9.19. Për sa më lart, rezulton se subjekti nuk ka kryer hetimet e nevojshme në kohë. Nga aktet duket se subjekti ka shkëlur edhe detyrimin e përcaktuar nga neni 291, pika 2¹⁸ e Kodit të Procedurës Penale, për njoftimin menjëherë të vendimit të mosfillimit të procedimit kallëzuesve, të cilin rezulton ta ketë dërguar pas një muaji e 12 ditësh. Shkelja e afatit të njoftimit nuk është konstatuar nga gjykata. Nga arsyetimi i aspekteve të tjerë që rezultojnë nga vendimi i gjykatës, konfirmuar qoftë gjatë hetimit administrativ në Komision dhe potencuar nga Komisionerja Publike e Drejtuesi i SPAK, trupi gjykues çmon se, nën dritën e dispozitës së pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, subjekti ka treguar mangësi të aspektit ligjor për të ndërmarrë veprimet e duhura hetimore dhe për të interpretuar ligjin. Edhe rrethanat në të cilat kjo çështje erdhi në vëmendje të organeve të rivlerësimit, si pasojë e kallëzimit dhe denoncimeve të përsëritura nga e njëjta palë për të njëjtin problem, u vlerësuan si pjesë integrale e analizës së kryer në Kolegj për mungesë efektiviteti të treguar nga subjekti në funksion të mbrojtjes së të drejtave të palëve në proces.

¹⁵ Neni 66, germa “dh” e Kodit Penal lexuar së bashku me nenin 149/a.

¹⁶ Me vendimin e gjykatës nr. {***}, datë 01.12.2020, subjekti u urdhërua që të hetojë pranë Drejtorisë së Markave dhe Patentave nëse produkti i tregtuar nga kompanitë e kallëzuara është markë e mbrojtur. Gjithashtu, subjekti u urdhërua të hetojë në drejtim të pëlqimit të pronarit të produktit. Nga ana tjetër, subjekti në ankim shprehet se dokumentacioni nga Drejtoria e Markave dhe Patentave është administruar, dhe se çështja nëse produkti italian është i mbrojtur, sipas saj nuk hyn në sferën e detyrave të DPPI-së.

¹⁷ Neni 290 parashikon rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, që janë - 1. Procedimi penal nuk mund të fillojë kur: [...] ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston; [...].

¹⁸ 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

10. Kallëzimi penal nr. {***}/2017

10.1. Ky denoncim është një ndër 10 çështjet e hetuara, për të cilat Komisioni nuk është shprehur në vendim. Denoncuesi, z. A. K., ankohet se subjekti ka zvarritur hetimin për kallëzimin penal të depozituar prej tij për ndërtim të paligjshëm dhe pushtimin e tokës dhe nuk e informoi atë në cilësinë e kallëzuesit/viktimës, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 58/dh të Kodit të Procedurës Penale. I njëjti denoncues ka paraqitur ankim për subjektin edhe pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në datën 28.10.2020. ILD-ja informoi kallëzuesin se ankesa do të shqyrtohet dhe në datën 18.01.2021 dhe dërgoi dokumentacionin në Komision. Nga aktet nuk rezulton një vendim i marrë nga ILD-ja në kohën kur është kryer procesi në Komision.

10.2. Komisionerja Publike dhe në vijim Drejtuesi i SPAK-ut kërkuar të hetohet nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale, kanë qenë në përmbushje të standardeve të përcaktuara nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Në kushtet që hetimi ka nisur nga korriku 2017 e ishte ende papërfunduar deri më së paku në prill 2022¹⁹, ngrihen pyetje për kohëzgjatje e pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si dhe mënyrës së zbatimit të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, që normon pezullimin e hetimeve dhe për analizë për përmbushjen e standardeve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me aftësinë për të hetuar, marrë urdhra e vendime. Gjithashtu, në bisedimet përfundimtare, Drejtuesi i SPAK-ut nënvizoi se nga korriku 2017 kur është regjistruar kallëzimi penal, deri në kohën kur subjekti ka marrë vendim për pezullimin e hetimit, në nëntor 2020, subjekti nuk ka ndërmarrë në mënyrë logjike hetimin ndonëse ka pasur detyra të qarta nga vendimet gjyqësore që kanë kontrolluar ushtrimin e ndjekjes penale. Këto aspekte tregojnë mangësi të natyrës së aftësisë profesionale të prokurorit për pamjaftueshmëri hetimore, konfirmuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ajo e Apelit. Aktet e procedimit u administruan në Kolegj në vijim të hetimit të kërkuar nga Drejtuesi i SPAK²⁰.

10.3. Denoncuesi është pronari i një shtëpie dhe trualli në Jalë të fshatit Vuno, Himarë. Këtë shtëpi, ia ka dhënë me qira 5-vjeçare [sipas një aktmarrëveshjeje me shkrim], z. E. B., për të kryer aktivitete të *partisë politike dhe* të turizmit. Denoncuesi pretendon se qiramarrësi ka nisur të kryejë punime - - ndërtimin e çatisë dhe një kuzhine -- pa miratimin e tij dhe pa leje ndërtimi, ndërsa nuk ka paguar qira për 2 nga 5 vite. Denoncuesi ka paraqitur kallëzim në polici kur ka konstatuar punimet. Ai shprehet se i ka kërkuar z. B. të largohet nga prona e tij, por ai nuk është larguar dhe ka ushtruar aktivitet turizmi në të. Në vijim çështja u dërgua për ndjekje në prokurori, me prokuror subjektin.

10.4. Në rezultatet e hetimit, Komisioni konstatoi se subjekti ka zvarritur hetimet dhe nuk ka kryer hetime të plota dhe pa një arsyetim të motivuar, sikurse edhe për moskryerjen e menjëhershme të verifikimeve të mundshme e të nevojshme. Subjekti ka argumentuar se çështja është ende në fazën e hetimit paraprak dhe pezullimi i hetimeve tregon se janë ezauruar mundësitë e momentit për të kryer veprime hetimore e do të duhet të angazhohen strukturat e rendit për të vijuar me grumbullimin e informacionit. Pa u paraqitur një e dhënë e re, çështja vijon të mbetet në ngarkim të saj për të rifilluar në çdo kohë. Në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti theksoi që çështja është ende e papërfunduar, ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme dhe pezullimi është mjeti më i përshtatshëm procedural në rrethanat konkrete të çështjes. *Së fundmi*, subjekti potencoi edhe që denoncuesi nuk ka ushtruar ankim kundër vendimit të pezullimit të marrë prej saj dhe që kallëzimi kishte problematika identifikimi të

¹⁹ Gjatë procesit të zhvilluar në Komision.

²⁰ Meqenëse në dosje nuk administroheshin të gjitha aktet, mbi bazën e kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Kolegji mori informacion nga Gjykata dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

personit përgjegjës dhe që shtesa ishte ndërtuar në një objekt pa leje dhe të skualifikuar për t'u legalizuar.

10.5. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i bazuar konstatimi i Drejtuesit të SPAK-ut dhe Komisioneres Publike. Subjekti rezulton të ketë mangësi në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve hetimore, nëpërmjet disponimit me urdhra e akte nëpërmjet të cilave të jepej përgjigje në kohë, në funksion të vendosjes para përgjegjësisë apo përmbylljes së hetimeve në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale. Veprimet e konstatuara janë kryer në kohëzgjatje të konsiderueshme dhe paraqiten vetëm si pasojë fundore e detyrimit për shkak të urdhrave konkrete të gjykatës. Nga aktet rezulton, ndër të tjera, se subjekti nuk ka hetuar për veprimet e pretenduara nga kallëzuesi, përfshirë ndërtimin e paligjshëm -- sikurse konstatuar nga drejtuesi i prokurorisë në korrik 2017. Në të njëjtën linjë, ndonëse referimi i kallëzimit penal përmban mjaftueshëm dokumentacion²¹ nga i cili derivohen të dhëna të dobishme për hetimin efektiv, pezullimi pas një viti e gjysmë më pasojë ngurtësimin e situatës në të njëjtën gjendje edhe në prill 2022, gjatë procesit në Komision, u vlerësua së bashku me faktin që edhe ato veprime hetimore që janë kryer kanë qenë urdhëruar nga gjykata, në mënyrë specifike dhe pas periudhash relativisht të gjata kohore e me ndërprerje të pajustificuara. Ndër to, trupi gjykues sjell si shembull vendimin për të kryer akt ekspertim, urdhëruar nga gjykata që prej dhjetorit të vitit 2017, të cilin subjekti e ka marrë vetëm në 11 tetor 2018. Ndërsa vendimi i dytë për kryerjen e veprimeve hetimore dhe ai për pezullimin e hetimeve janë marrë përkatësisht në gusht dhe nëntor 2020, në periudhën e ndërmjetme, mes korrikut 2017 dhe pezullimi i hetimit në nëntor 2020, subjekti ka kryer veprime sporadike hetimore. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

10.6. Nga aktet në fashikull rezulton se materiali kallëzues është regjistruar në datën 03.07.2017 dhe dy ditë më pas, subjekti/prokurorja e çështjes ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal. Drejtuesi i seksionit ka shënuar se hetimi mund të orientohet edhe në drejtim të ndërtimit të paligjshëm²². Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka shfuqizuar vendimin e subjektit [me ankim të kallëzuesit] më 07.12.2017 dhe ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për ndërtim të paligjshëm dhe kryerjen e një sërë vendimesh hetimore konkrete²³. Gjykata e Apelit Vlorë, vënë në lëvizje nga ankimi i subjektit, me vendim të datës 20.02.2018, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Në vijim, më 28.03.2018, subjekti ka vendosur regjistrimin e procedimit penal, për veprën penale të ndërtimit pa leje, sipas nenit 199/a të Kodit Penal dhe ka kryer disa veprime hetimore, në maj dhe korrik 2018, caktim eksperti në tetor 2018 dhe, pas një urdhri të prillit 2019 për këqyrjen e

²¹ Nga procesverbali i datës 03.07.2017, mbajtur nga punonjës të IMT-së Bashkia Himarë, dokumentohet rikonstruksion i objektit ekzistues dhe shtesa anësore, pa leje nga Bashkia. Me vendimin datë 04.07.2017 të të njëjtit institucion janë pezulluar punimet dhe marrë vendim për prishjen e objektit në datën 10.07.2017. Sipas akteve, ndërmjet IMT-së Himarë dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ka vijuar një korrespondencë e gjatë që daton nga muaji tetor i vitit 2017, deri në vitin 2019, lidhur me zbatimin e vendimit të prishjes së objektit të paligjshëm.

²² Neni 199/a i Kodit Penal: "Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasojë të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet".

²³ Ndër të tjera, gjykata arsyetoi se: (i) organi i akuzës nuk mori në pyetje personat që kishin dijeni për veprën penale, z. E. B., punonjësit e IMT Bashkia Himarë që kanë mbajtur procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes administrative – ndërtimit pa leje; (ii) nuk është këqyruar vendi i ngjarjes nëse janë kryer punime shtesë sipas kallëzimit; (iii) duhet të ishte kryer akti i ekspertimit topograf; (iv) duhet të ishte sekuestruar praktika administrative pranë IMT Bashkia Himarë që lidhet me ankimin e z. A. K.. Gjithashtu, vetëm pas kryerjes së veprimeve hetimore të nevojshme, organi i akuzës duhet të jetë në gjendje të arrijë në përfundim më të drejtë dhe objektiv nëse ndodhemi përpara veprës penale, dhe në lidhje me kualifikimin juridik të faktit penal dhe identifikimin e autorit.

vendit të ngjarjes dhe pyetjen e disa personave, vendimi i radhës daton në gusht 2020. Më 16.11.2020 subjekti ka marrë vendim për pezullimin e hetimit duke argumentuar se nuk njihet autori i veprës penale. Veprimet e kryera në harkun kohor mars 2018 deri në prill 2019 përfshijnë këqyrjen e dosjes gjyqësore, kërkim informacioni nga Bashkia Himarë dhe foto nga vendi i ngjarjes dhe pyetje e të kallëzuarit dhe punonjësve të Bashkisë e, *së fundmi*, një vendim për caktim eksperti, ky i fundit i urdhëruar nga gjykata që në dhjetor 2017. Urdhri i radhës, për kryerjen e veprimeve hetimore që mban datën 02.04.2019, ka fokus sërish këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe pyetjen e disa personave. Ndërsa, ai i fundit, i datës 04.08.2020, urdhëron marrje në pyetje dhe kryerjen e të gjithë veprimeve të tjera hetimore të nevojshme.

10.7. Në arsyetim të ankimit, subjekti analizon se në kallëzim nuk rezulton asnjë fjali që të lidhet me veprën penale të “ndërtimit pa leje” apo të “ndërtimit të paligjshëm”²⁴. Po aty, ajo ka argumentuar se nuk është qëllim i gjykatës të vërtetojë fakte apo të plotësojë kallëzimet penale, sikurse në rastin konkret.

10.8. Sikurse arsyetuar më sipër, në kushtet që subjekti ka ndërmarrë gjithë veprimet e saj, kjo çështje nuk konsiderohet e përjashtuar nga vlerësimi si çështje në proces, për shkak të ndalimit që parashikon neni E i Aneksit të Kushtetutës, për të kryer verifikimet deri në këtë moment procedural. Subjekti është shprehur dy herë, ka marrë dy herë vendime për mosfillim dhe pezullim përkatësisht dhe kontrolli përfshiu veprimet e saj deri në kohën kur ajo ka dhënë shpjegime. *Së dyti*, trupi gjyqësor i Kolegjit vëren se arsyetimi i subjektit se gjykata ka tejkalluar tagrat e saj në kushtet që nënkupton “plotësimin” e kallëzimit nga gjykata është i pakuptimtë. Duke qenë se cilësimi i veprës penale, sikurse edhe ndjekja penale janë detyrë e prokurorisë, përfshirë edhe nëpërmjet të dhënave që rezultojnë gjatë hetimit, është e qartë që qoftë kallëzuesi, ashtu edhe hetimi i kryer nga policia referojnë qartë²⁵ se fokus i faktit penal të akuzuar është një ndërtim i kryer pa leje, sikurse referuar nga marrja në pyetje e kallëzuesit. Në nenin 332/d të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar rasti kur del se fakti është ndryshe nga ai i përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq apo kur del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur, prokurori ndryshon akuzën. Për më tepër, mbështetur në parimet procedurale penale, prokurori që drejton edhe hetimet ka për detyrë që të zbulojë se cili është fakti penal dhe të mos kufizohet vetëm në faktin e parashtruar nga kallëzuesi.

10.9. *Së fundmi*, edhe shpjegimet e subjektit, për efekt të pezullimit për hetim të mëtejshëm nga policia meqenëse nuk njihet autori, nuk duket të ketë marrë në konsideratë disa aspekte që rezultojnë nga kallëzimi. Konkretisht, kallëzuesi ka konfirmuar që marrëdhënia e tij e qirasë ishte me të kallëzuarin, i cili, si përfaqësues i një partie politike, kishte marrë me qira afatgjatë shtëpinë e tij e pretendohet të kishte munguar pagesën e qirasë, por edhe ndërhyrjet pa laje. Referuar procesverbaleve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit u konstatua ndërtimi i paligjshëm/pa leje në shtëpinë e kallëzuesit dhe u mor vendimi i shembjes së saj. Në respektim edhe të vendimeve unifikuese penale të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2002 dhe nr. 2/2013, në të cilët është trajtuar

²⁴ Në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë është shënuar se kallëzimi është paraqitur për veprën penale të “pushtimit të tokës” dhe të “ndërtimit të paligjshëm”.

²⁵ Në një procesverbal të datës 29.06.2017, për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, Oficeri i Policisë Gjyqësore ka marrë në pyetje kallëzuesin dhe mori në dorëzimin vendimin e pronësisë dhe vërtetimin hipotekor të pronës së kallëzuesit. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë referohet se Komisariati i Policisë ka përcjellë material kallëzues, në datën 03.07.2017 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndaj z. E. B. për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm dhe të pushtimit të tokës, parashikuar nga nenet 199/a dhe 200 të Kodit Penal.

koncepti i subjektit procedural të *personit të cilit i atribuohet vepra penale*²⁶, referuar ankimit, denoncuesi ka dhënë emrin e personit të cilit ia atribuon veprën penale. Edhe gjykata e ka trajtuar çështjen në të njëjtin kontekst për plotësim hetimesh.

10.10. Në rastin konkret nuk u argumentuan në mënyrë bindëse arsye për të cilat mosshënimin e personit që i atribuohet vepra penale bëhet i kuptimtë. Ky mosveprim i subjektit tregon më së paku, qëllimin e saj për t'iu shmangur afateve të përcaktuara në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale. Zbatimi i këtij detyrimi vlerësohet nga trupi gjykues i Kolegjit në aspektin e aftësive organizative të subjektit, për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, sipas pikës 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016²⁷.

10.11. Subjekti nuk shpjegoi nëse mori vendim për zgjatje të afateve të hetimit pas kalimit të afatit 3-mujor, në respektim të nenit 324, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale²⁸ dhe kohëzgjatja nga vendimi i formës së prerë deri në momentin e pezullimit të hetimeve nga subjekti, që nënkupton kohën gjatë të cilës subjekti kreu të gjitha veprimet e mundshme hetimore, kaluan 2 vjet e gjashtë muaj. Ky afat, në respektim të dispozitës së sipërcituar të Kodit të Procedurës Penale, tejkalon edhe afatin e hetimeve paraprake për vepra penale shumë komplekse, verifikimit të të cilit [*afatit 3-mujor i hetimeve paraprake*], subjekti iu shmang duke mosshënuar në regjistër emrin e personit që i atribuohet vepra penale.

10.12. Në përmbledhje, edhe në analizën e këtij procedimi, sikurse edhe në procedimin tjetër të analizuar më sipër, subjekti paraqet një mënyrë sjelljeje që tregon zvarritje apo mosmarrje të veprimeve hetimore në mënyrë efikase dhe në interpretim të drejtë të detyrave për efekt të ndjekjes penale, duke shkaktuar tejzgjatje procedure në vijim të një mënyre interpretimi, që duket e pambështetur në aspektet bazike të hetimit për efekt të mosfillimit të procedimit penal, edhe duke abstraguuar nga fakti që gjykatat rrëzuan logjikën ligjore të pretenduar prej saj në moskryerjen e hetimit. *Së fundmi*, në kushtet kur nga aktet kishte informacion mbi të cilin mund të thellohej zbardhja e ngjarjes, ndërsa edhe deri në prill 2022 nuk ka zhvillime për qëllim të faktit penal të kallëzuar, është me pasoja qoftë për pandëshkueshmërinë e fenomenit, ashtu edhe për interesat e cenuara të pronarit/individit kallëzues.

10.13. Përfundimisht, nga analiza e mësipërme, trupi gjykues vëren se është i bazuar arsyetimi i Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të SPAK-ut se subjekti ka treguar mangësi të aftësisë organizative në drejtim të përmbushjes së standardeve të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

²⁶ Paragrafët 10 dhe 11 të VU nr. 2/2013 - “personi, të cilit i atribuohet vepra penale”, “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime” (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – “b” e “d” dhe 308, etj.) dhe më pas “i pandehur” që ndeshet në shumë dispozita të Kodit të Procedurës Penale. Autori i mundshëm i veprës penale mund t'i marrë këto emërtime në faza të ndryshme të procedimit penal. Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim. [...] Cilësia e personit, të cilit i atribuohet vepra penale, fillon: a) ose kur njoftuesi i saj mendon se e di, se cili mund të jetë autori i veprës penale dhe prokurori shënon paralelisht në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, krahas veprës edhe emrin e personit kur ai njihet; ose b) mbasi është bërë regjistrimi i veprës penale, që nga çasti i mëtejshëm kur nga hetimet rezulton një emër personi të cilit, i atribuohet vepra penale.

²⁷ Kjo dispozitë parashikon: “[...] 4. Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit”.

²⁸ 1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj.

11. Procedimi penal nr. {***}/2017

11.1. Kjo është një ndër çështjet e analizuara nga Komisioni, për të cilat nuk ka një qëndrim në vendimin përfundimtar. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar procedimi penal në fjalë, mbi bazën e vendimit të gjykatës civile që deklaronte të falsifikuar një dokument shtetëror. Nëpërmjet tij, trashëgimtarët e një individi [z. S. R.] fituan pronësinë mbi një sipërfaqe prej 2.900 m² në zonën e “Ujit të Ftohtë”, Vlorë²⁹. Sipas vendimit të gjykatës, kallëzuesit [z. M. Ç.] i është kthyer sipërfaqja 2.600 m², ndërsa sipas matjeve të ZVRPP-së Vlorë sipërfaqja është 2.950 m². Për shkak të mbivendosjes së krijuar nga mospërputhja, në gjykimin civil, paditësi/kallëzues ka kërkuar deklarimin e falsitetit të aktit “Libër themeltar i pasurisë së paluajtshme”, me pretendimin se akti i falsifikuar është përdorur nga trashëgimtarët R. për përfitimin e tokës³⁰. Gjykata, ndër të tjera, konstatoi se ky akt: (i) nuk rezultoi i administruar në Bashkinë Vlorë; (ii) është i falsifikuar, pasi në përmbajtjen e tij ka të dhëna kontradiktore; si dhe (iii) vendimi ka disponuar vetëm shtetëzimin e banesës së familjes R. kundrejt vlerës përkatëse, por nuk trajton shtetëzimin e ndonjë sipërfaqeje trualli 3.300 m². Gjykata konkludoi se “Libri themeltar i pasurisë së paluajtshme”, që referon vendimin e Komitetit Ekzekutiv të Komisionit të Kthimit të Pronave të Rrethit Vlorë, të vitit 1953, pasqyron të dhëna të pavërteta.

11.2. Në vijim, u regjistrua procedimi penal me nr. {***}, datë 11.12.2017, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Në datën 11.12.2017, z. M. Ç. paraqiti kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ndaj trashëgimtarëve të z. S. R., me pretendimin se, sipas vendimit të gjykatës, titulli i tyre i pronësisë buronte nga akte të falsifikuara.

11.3. Komisionerja Publike, në ankim, ka kërkuar të hetohet nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale, të filluar në muajin dhjetor 2017, deri aktualisht, janë në përmbushje të standardeve të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime. Gjithashtu, sipas Komisioneres Publike, vërehen afate kohore të pajustificuara në zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në vlerësim të Komisioneres Publike, shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ nuk gjejnë pasqyrim në aktet dhe veprimet e ndërmarra prej saj. Logjika mbi të cilën bazohen prapësimet e subjektit në rezultatet e hetimit në Komision nuk është materializuar në akte procedurale, qoftë për mosnjohjen e autorit të veprës penale, parashkrimin të veprës penale apo rënien e faktit penal, për shkak të vendimit civil të Gjykatës së Apelit Vlorë. Edhe Drejtuesi i SPAK-ut gjatë seancës në Kolegj, potencoi veprimtari të pamjaftueshme hetimore, sikurse konfirmuar nga gjykatat e të dy shkallëve.

11.4. Subjekti i rivlerësimit në rezultatet e hetimit, sikurse edhe gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, kundërshtoi konstatimin e bazuar në arsyetimin e gjykatës, duke kontestuar bazueshmërinë e tij. Ajo ritheksoi se nuk është gjendur dokumenti origjinal që të bëhet ekspertimi i tij për falsitet. Nga ana tjetër, ashtu sikurse konstaton Komisionerja Publike në ankim, edhe në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti u ndal veçanërisht në një linjë argumentimi që fokusohet rreth mënyrës sesi lëvizin fashikujt

²⁹ Në vendim, gjykata arsyetoi se ekzistojnë mospërputhje midis sipërfaqeve të kthyera në pjesën e dispozitivit të vendimit të datës 19.4.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe sipërfaqes që rezultoi nga hedhja grafike sipas hartave të ZVRPP-së Vlorë.

³⁰ Sipas sqarimeve në prokurori të ish shefit të zyrës juridike në Bashkinë e Vlorës, z. V. S., ky dokument bën pjesë në regjistrat e pasurive të paluajtshme të regjistruara nga shteti i mëparshëm në vitet 1945 – 1967. Këto pasuri administroheshin nga ish-Ndërmarrja Komonale e Banësve dhe plotësimi i regjistrave kryhej nga stafi I ndërmarrjeve në mënyrë deklarative. Këto regjistra, sipas deklaramit të z. S., u dorëzuan në vitin 1999 në Bashkinë Vlorë pa procesverbal, pa inventar dhe pa asnjë akt ish kryetarit të Bashkisë Vlorë. Në vitet 2000 – 2002 dokumentet iu lëshuan qytetarëve me kërkesë të tyre. Gjithashtu, ka deklaruar se në vitin 2002 i janë dorëzuar task forcës pranë Kryeministrisë.

nga gjykata në prokurori, për të ilustruar sesi prokurori e rifillon hetimin vetëm pasi i vihet në dispozicion fashikulli, i cili vijon të mbetet pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Po ashtu, ndonëse pretendoi që vendimi civil i gjykatës së shkallës së parë që shpalli falsitetin e aktit është prishur nga Gjykata e Apelit dhe çështja është kthyer për rigjykim, subjekti nuk ka sjellë akte mbi të cilat të mbështetet ky argument. Afati i caktuar nga gjykata, në rastin e veprave pa autor, konsiderohet sugjerues ndërkohë që ajo ka edhe çështje të tjera prioritare për të hetuar përpos çështjeve dhe urdhërimeve të gjykatës. Ka kryer veprimet e urdhëruara dhe nga hetimi ka rezultuar se akti i pretenduar i falsifikuar, i përdorur nga Bashkia, nuk gjendet. Përgjigjet nga zyrat e arkivës janë marrë edhe gjatë procesit civil dhe fashikulli i gjykatës civile është administruar në dosjen penale. Kryerja sërish e disa veprimeve hetimore do të përbënte zvarritje të procesit.

11.5. Nga analiza e akteve në fashikull dhe shpjegimeve e pretendimeve në seancën publike, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit i gjeti të bazuara kërkimet e Komisioneres Publike dhe të Drejtuesit të SPAK. Edhe në vlerësimin e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti ka treguar mangësi në ndërmarrjen në kohë të veprimeve hetimore, të evidentuara edhe në vendimet e gjykatës. Për më tepër, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se veprimet e ndërmarra tregojnë hapësira kohore të pajustificuara me vendimmarrje për rifillim hetimi, edhe muaj pasi subjekti është urdhëruar nga gjykata për të rifilluar hetimet, të cilat subjekti nuk arriti t'i shpjegojë bindshëm. Arsytimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

11.6. Në rezultatet e hetimit, Komisioni konstatoi se deri në datën 10.03.2023 subjekti nuk përfundoi hetimet shtesë të lëna detyrë nga gjykata. I vetmi veprim hetimor është *urdhri për rifillimin e hetimit paraprak*, i datës 22.12.2020. Për rrjedhojë, Komisioni konstatoi mungesën e veprimeve hetimore, në kundërshtim me afatin 3-mujor të parashikuar nga neni 323³¹ i Kodit të Procedurës Penale, pasi subjekti ka zvarritur hetimet.

11.7. Nga aktet në fashikull rezultoi se urdhri i parë i subjektit për delegimin e veprimeve hetimore Oficerit të Policisë Gjyqësore mban datën 05.01.2018. Nëpërmjet tij subjekti disponon për kërkim informacion pranë organeve kompetente, lidhur me disponimin e Librit Themeltar vërtetësia e të dhënave të të cilit kontestohet, pyetjen e personave që kanë dijeni, pyetjen e juristëve të ZVRPP-së që kanë kryer veprimet në kartelat përkatëse dhe çdo veprim hetimor i nevojshëm, me afat deri në datën 09.02.2018. Në datën 08.01.2018, subjekti kërkoi informacion nga Arkivi Shtetëror Vendor Vlorë. Ky institucion dërgoi informacion të detajuar në datën 12.01.2018, ndër të tjera, edhe rreth mungesës së "*Librit themeltar i pasurisë së paluajtshme*"³², dhe që aktet ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror, në Tiranë. Gjithashtu, në këtë shkresë, referohet, ndër të tjera, edhe se në vitin 1997 punonjësi i ngarkuar me ruajtje e dokumenteve të arkivit, është dënuar penalisht për shkak se janë konstatuar parregullsi në lidhje me detyrën. Në datën 20.12.2019, dy vite pas kallëzimit, subjekti ka kërkuar pushimin e çështjes me arsyetimin se faktet nuk parashikohen nga ligji si vepër penale dhe/ose janë parashkruar. Në kërkesën për pushimin e çështjes, subjekti ka cituar aktet dhe provat e përdorura për çështjen objekt shqyrtimi, që janë pa data. Në dosje nuk disponohen akte të saj për zgjatje të afatit të hetimit. Subjekti analizoi se nuk u gjet në asnjë institucion "*Libri themeltar i pasurisë së paluajtshme*", i cili përmban disponimin e pretenduar për shtetëzimin e një banese në emër të trashëgimlënësit. Subjekti arsyetoi se fakti i kallëzuar nuk mund të ndiqet prej saj për shkak

³¹ "[1.] Brenda përfundimit të afatit ligjor të hetimeve, prokurori vendos sipas paragrafit 6 të nenit 327 të këtij Kodi. 2. Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjatë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b" të nenit 75/a të këtij Kodi. [...]".

³² Sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ky dokument nuk administrohet as në Bashki/arkiv, as në ZVRPP.

të kalimit të afatit parashkrues të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve dhe ndaj trashëgimtarëve R. nuk mund të ushtrohet ndjekja penale për shkak të mungesës së dijenisë së tyre të falsitetit të dokumenteve.

11.8. Në vijim, sikurse edhe në çështjen e parë të analizuar më sipër, janë marrë katër (4) vendime gjyqësore, dy nga secila shkallë. Konkretisht, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, fillimisht pranoi kërkesën e subjektit për pushimin e çështjes, me arsyetim të njëjtë me subjektin, Gjykata e Apelit Vlorë, më datë 11.06.2020, vendosi ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe dërgimin e akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë³³, për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme brenda një afati 3-mujor, duke dhënë një sërë detyrash konkrete për prokurorinë dhe konstatuar mangësi në veprimet hetimore të deriatëhershme³⁴.

11.9. Pasi subjekti urdhëroi rifillimin e hetimeve më 22.12.2020, subjekti ka kërkuar sërish pushimin e çështjes. Me vendimin e datës 02.06.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka marrë vendim për rrëzimin e kërkesës për pushimin e procedimit dhe kthimin e akteve prokurorit/subjektit për vazhdimin e hetimeve brenda 90 ditëve nga marrja e vendimit formë të prerë. Gjykata ka konstatuar mangësi veprimesh hetimore dhe ka lënë detyrë kërkimin e informacionit pranë Zyrës së Task Forcës në Kryeministri, kërkimin e dokumentit pranë Arkivit Shtetëror Qendror, si dhe caktimin e ekspertit për të provuar nëse shënimi është i falsifikuar. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, vënë në lëvizje nga subjekti me ankim. Gjykata e Apelit Vlorë, më datë 21.07.2021, e la në fuqi vendimin e shkallës së parë dhe vlerësoi se hetimet nuk ishin të plota³⁵.

11.10. Ky dokument u përcoll në prokurori në datën 20.10.2021 dhe në datën 25.10.2021 subjekti rifilloi hetimin. Në urdhrin për delegimin e veprimeve hetimore OPGj-së, që mban datën 06.04.2022, subjekti ka urdhëruar edhe kryerjen e ekspertimit teknik dhe veprime të tjera brenda datës 30.04.2022. Kërkimin pranë Kryeministrisë të aktit të kontestuar -- “Libri Themeltar i pasurisë Vlorë” – duke zgjedhur edhe që të nënvizojë se veprimet kanë për shkas urdhrat e orientimet e gjykatave³⁶. Nga këto veprime dhe aktet deduktohet që ndonëse afati 90-ditor për kryerjen e veprimeve duhet të ishte 20 janari 2022, subjekti ka deleguar dhe nisur veprimet vetëm në prill 2022,

³³ Në datën 14.12.2020 nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave është paraqitur një kallëzim penal, nëpërmjet të cilit kallëzuesi dërgoi pranë prokurorisë material plotësues, si dhe për ta vënë në dijeni nëse aktet që nuk gjenden/ mungojnë janë përdorur apo mund të përdoren në të ardhmen.

³⁴ Gjykata e Apelit ka konstatuar, ndër të tjera, se subjekti/prokuroria nuk ka arsyetuar për mungesën e dijenisë së trashëgimtarëve që pretendojnë fitimin e pronësisë së kontestuar, dhe që subjekti nuk ka kryer veprime hetimore të mjaftueshme në këtë drejtim ndërsa deklarimet e dy personave të pyetur [një trashëgimtar dhe ish-juristi i Bashkisë në vitet 1998-2002] provojnë se trashëgimlënësi nuk ka pasur tokë bujqësore në pronësi dhe as ka përfutur kompensim në masën e sipërfaqes në vendin ku është regjistruar prona [3.300 m² në Ujin e Ftohtë, Vlorë]. Në lidhje me regjistrat [e pronave] dorëzuar në Bashki, Gjykata e Apelit arsyetoi se prokuroria u mjaftua vetëm me deklarimet e z. S. pa sqaruar se si janë vënë në dijeni personat në lidhje me ekzistencën e dokumenteve, por edhe pa hetuar më thellë në lidhje me deklarimet e titullarit të arkivit, i cili deklaroi se “për shkak të ndërhyrjeve të bëra në dokument, punonjësi që e administronte Librin themeltar të pasurive të paluajtshme është arrestuar dhe regjistrat u tërhoqën në Tiranë”. Apeli konstatoi se organi i akuzës nuk hetoi as përse në të gjitha proceset gjyqësore me palë trashëgimtarët R., u përdor “Libri themeltar i pasurive të paluajtshme” dhe jo vendimi, datë 23.01.1953, i Komitetit Ekzekutiv të Komisionit të Kthimit të Pronave të Rrethit Vlorë, që gjendet në Fondin Arkivor të Republikës së Shqipërisë.

³⁵ Sipas Gjykatës së Apelit, në mënyrë të përmbledhur, ndër të tjera, referohet se veprimet hetimore nuk tregojnë për veprime të ndërmarra nga organi i akuzës për shuarjen e dyshimeve se jemi përpara elementeve të veprës penale të falsifikimit. Kjo gjykatë e gjeti të pabazuar argumentin e prokurorit/subjektit për kushtet e parashkrimit të ndjekjes penale; organi i akuzës nuk ka hetuar lidhur me deklarimet e z. S. se libri u dorëzua në Kryeministri; si dhe organi i akuzës nuk mund të përdorë si argument për pushimin e procedimit mungesën e dijenisë së trashëgimtarëve R. për falsitetin e dokumentit, pasi nuk ka hetuar në mënyrë të plotë përse në proceset e iniciuara prej tyre, nuk janë përdorur dokumente të rregullt arkivorë, por këto dokumente me përmbajtje të falsifikuar.

³⁶ Me shënimin: “Duke qenë se gjyqtarët e seancave paraprahe kanë konkluduar se gjendet në këtë institucion”.

ndërsa afati i dhënë OPGj-së për kryerjen e veprimeve ishte vetëm 24 ditë. Këto momente kohore përkojnë pjesërisht me përfundimin e hetimit administrativ në Komision³⁷. E thënë ndryshe, veprimet e para të kryera, në këtë rast urdhri i delegimit, daton më shumë se 5 muaj më pas. Sikurse edhe arsyetuar më sipër, subjekti nuk ka respektuar afatet e caktuara nga gjykata dhe nuk ka nxjerrë urdhër për zgjatje të afatit të hetimeve, por ka kryer disa veprime hetimore.

11.11. Përfundimisht, prokurori, të cilit i kaloi çështja në vijim, ka kërkuar pushimin e procedimit, për shkak se falsifikimi i dokumentave nuk u provua, bazuar në relacionin për përfundimin e hetimit, hartuar nga OPGj-ja në datën 19.06.2023. Sipas këtij akti, Kryeministria informoi që nuk rezultoi të jetë dorëzuar dokumentacioni i kërkuar. Arkivi Shtetëror Qendror ka informuar se në dokumentet që disponon, në emër të z. S. R. nuk u gjetën të dhënat e kërkuara, ndërsa trashëgimtari, z. Ç. S., ka dorëzuar kopje të Librit Themeltar të Pasurisë, Vlorë, faqe 440, mbi të cilin u krye akti i ekspertimit, që konkludoi se *nuk u evidentuan ndërhyrje të tjera mekanike apo kimike, fshirje, shtesa, korrigjime apo shenja [...]*. Nga ekzaminimet e dorëshkrimeve, u konstatua se rekuizitat janë dorëshkuar nga i njëjti person. Pra nga ekspertimi i kryer mbi fotokopjen e librit, u konstatua se nuk është i falsifikuar dhe Oficeri i Policisë Gjyqësore sugjeroi që të paraqitet kërkesë për pushimin e çështjes penale [objekt analize].

11.12. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar, në Komision, se vendimi i gjykatës që ktheu çështjen për hetim nuk caktoi detyra konkrete dhe bie ndesh me vendimin e formës së prerë të vitit 2001, që iu njohu pronësinë me parashkrim fitues trashëgimtarëve R. dhe për shkak të afatit të parashkrimit për një akt të përpiluar në vitin 2001, dhe ka shtuar edhe që për vendimin gjyqësor të bazuar në dokumente të falsifikuara *praktikat hetimore dhe gjyqësore kanë mbajtur qëndrimin se nuk përbën akt të falsifikuar pasi jepet në emër të Republikës së Shqipërisë*.

11.13. Nga sa më sipër, duke abstraguuar nga thelbi i mënyrës sesi është zgjidhur procedimi penal, trupi gjykues vëren se subjekti nuk ka dhënë përgjigje konkrete përse nuk zbatoi urdhërimet e gjykatës brenda afatit të përcaktuar apo përse në kushtet që procedimi kishte nisur që në vitin 2018 nuk pezulloi hetimet meqenëse nuk gjendej autori në zbatim të nenit 326³⁸ të Kodit të Procedurës Penale, sikurse edhe përse brenda afatit nuk kërkoi pushimin e çështjes, meqenëse pretendon se detyrat e gjykatës nuk jepnin rezultate. Ekzistenca e faktit penal, falsiteti i një dokumenti ishte deklaruar nga gjykata e shkallës së parë dhe detyra e subjektit do të deduktohej se ishte identifikimi i personit që ishte autori i veprës.

11.14. Nga ana tjetër, janë të pabazuara pretendimet se Gjykata e Apelit nuk ka caktuar detyra konkrete në kushtet që në pjesën arsyetuese të vendimit ka veprime specifike, sikurse edhe orientimin që duhet të marrin hetimet. Në pikën fundore, ndonëse gjykatat kanë arritur në një qëndrim të njëjtë me subjektin, arsyetimi ka qenë i ndryshëm. Konkretisht, pas urdhërimit nga gjykata për të administruar informacion nga Zyra e Task Forcës në Kryeministri dhe dokumentacionit pranë Arkivit Shtetëror Qendror dhe caktimin e ekspertit për të hetuar nëse shënimi është i falsifikuar. Pasi janë kryer këto veprime dhe është përjashtuar ekzistenca e një veprë penale në përfundim të hetimit, prokurori, të cilit i ishte caktuar çështja, ka kërkuar pushimin e procedimit penal në vitin 2025. Nga aktet e administruara në Kolegj, rezultoi se Kryeministria informoi që nuk

³⁷ Komisioni i ka dërguar subjektit rezultatet e hetimit nëpërmjet një e-mail-i të datës 19.04.2022, ndërsa pyetësi i fundit, nr. 8, rezultoi t'i jetë dërguar asaj më 19.03.2022.

³⁸ “[1.] Kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve. 2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme. [...]”.

rezulton të jetë dorëzuar dokumentacioni i kërkuar, ndërsa në kopjen e Librit Themeltar të Pasurisë, mbi të cilin u krye akti i ekspertimit, eksperti konkludoi se nuk u evidentuan ndërhyrje të tjera mekanike apo kimike, fshirje, shtesa, korrigjime apo shenja³⁹.

11.15. Nën dritën e nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i Gjykatës së Apelit është i ekzekutueshëm dhe i detyrueshëm për zbatim. Shpjegimet e subjektit në rezultatet e hetimit, që vënë në diskutim detyrat e lëna nga gjykata, kur shprehet se vendimi dërguar subjektit për zbatim *bie ndesh me vendimin e formës së prerë të vitit 2001 që iu nje pronësinë trashëgimtarëve R. me parashkrim fitues*, apo që afatet e caktuara në dispozitiv nuk u zbatuan për arsye prioritesh, vijnë në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës. Po ashtu, në konsideratë të parimit të sigurisë juridike, vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk mund të jenë objekt diskutimi i mëtejshëm nga prokuroria. Ata janë të detyrueshëm për palët dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet⁴⁰. Subjekti ka zgjatur mbi *dy vjet* hetimet paraprake pas vendimit të Gjykatës së Apelit, ndërkohë që, nga momenti i paraqitjes së kallëzimit e deri në kohën kur ajo ishte në rivlerësim dhe çështja ende e papërfunduar, kishin kaluar rreth *pesë vjet*. Ky afat cilësohet si cenim i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, qoftë nën dritën e garancive konventore, por edhe atyre procedurale të ligjit të brendshëm.

11.16. Në përcaktimin e kohëzgjatjes normale të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, që përfshihen edhe afatet e hetimeve paraprake, GjEDNj-ja ka mbajtur në konsideratë faktorë të tillë si kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit dhe sjellja të autoriteteve përkatëse administrative dhe gjyqësore⁴¹. Në këtë kontekst, zbatuar në rrethanat konkrete, trupi gjykues vëren se subjekti ka mbajtur çështjen në fazën e hetimit paraprak për më shumë se dy vite. Në kushtet që nuk flitet për hetime komplekse apo me shumë të dyshuar, subjekti është mjaftuar vetëm me konstatimin e parashkrimit të ndjekjes penale pa arsyetuar shkaqet e zgjatjes së hetimit apo të nevojës për zgjatjen e afateve. Edhe sjellja e kallëzuesit nuk ka qenë penguese. Ai ka paraqitur edhe akte shkresore me argumentet e rrethanat që, sipas tij, provojnë faktet e parashtruara në materialin kallëzues prej tij. Është sjellja e autoritetit shtetëror – në këtë rast subjekti në cilësinë e prokurores – që me vonesat e pajustificuara, të krijuara pjesërisht edhe si pasojë e mungesës së veprimeve hetimore përcaktuese për rrjedhën e procedimit apo edhe të zbatimit të vendimit të Gjykatës së Apelit – ka krijuar te zgjatje të panevojshme që krijojnë premisa për procedim të kryer pa i dhënë vëmendje kohës së arsyeshme.

11.17. Afatet e përcaktuara në dispozitat procedurale penale mund të zgjaten deri në tre muaj dhe maksimalisht në dy vjet, në varësi të kompleksitetit të hetimeve, kushtëzuar edhe nga nxjerrja e urdhrave për zgjatjen. Për të respektuar kohëzgjatjen e hetimeve, është përgjegjës prokurori, i cili merr të gjitha masat që në bashkëpunim me policinë gjyqësore të marrë të gjithë masat që për efekt të kryerjes së një hetimi të drejtë dhe efikas, brenda periudhës hetimeve paraprake të ndërmarrë të

³⁹ Në relacionin për përfundimin e hetimit të Oficerit të Policisë Gjyqësore, datë 19.06.2023. Në dosje u administrua edhe kërkesa për pushimin e kësaj çështje, e shkurtit të vitit 2025 e prokurorit z. M. B., i cili ka vlerësuar se duhet të pushohet çështja pasi nga akti i ekspertimit rezultoi që nuk ka ndërhyrje mekanike, korrigjime, shtesa, skanime, apo shkrime prej personave të ndryshëm, dhe që për të pasur një figurë konkrete procedimi penal është e domosdoshme ekzistenca e elementeve si: (a) objekti i veprës penale; (b) ana objektive; (c) subjekti; dhe (ç) ana subjektive.

⁴⁰ Referuar vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që kanë trajtuar çështje lidhur me këtë dispozitë: nr. 23, datë 08.06.2007; nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 21, datë 16.04.2015 dhe nr. 41, datë 06.07.2016.

⁴¹ Guida për aplikimin e nenit 6 të KEDNj-së, për praktikën e zbatimit të afatit të arsyeshëm në procesin penal: https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_6_criminal_eng dhe vendimeve të GjEDNj-së, në çështjet si: König kundër Gjermanisë, 1978, § 99; Neumeister kundër Austrisë, 1968, § 21; Ringeisen kundër Austrisë, 1971, § 110; Pélassier dhe Sassi kundër Francës [GC], 1999, § 67; Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës, 2004, § 45; Chiarello kundër Gjermanisë, 2019, § 45; Liblik dhe të tjerët kundër Estonisë, 2019, § 91.

gjithë veprimet për zbulimin e autorit/personit që i atribuohet vepra penale⁴². Në “Manualin orientues mbi plotësimin e tabelave të aneksit nr. 2 të rregullores për vlerësimin profesional dhe etik të prokurorëve”, llogaritja e afateve fillon nga dita e shortit elektronik/manual dhe deri ditën/datën që mban vendimi i mosfillimit, ndërsa për procedimet penale “pa autor”, kohëzgjatja në hetim në këtë rast përlllogaritet periudha nga data e regjistrimit të procedimit penal deri në datën e kërkesës për pushimin e procedimit penal.

11.18. Në Metodologjinë e Pikëzimit⁴³, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit, Këshilli i Lartë të Prokurorisë ka përcaktuar që afati dyvjeçar, sipas nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, për hetimet paraprake, do të aplikohet njëloj edhe për veprat penale pa autor. Po sipas kësaj metodologjie, aftësitë organizative vlerësohen krahasuar me ngarkesën në punë dhe me efikasitetin edhe të prokurorëve të tjerë të prokurorisë në të cilën punon prokurori që vlerësohet.

11.19. Ndërsa trupi gjykues i Kolegjit e mori në konsideratë ngarkesën e çështjeve të përballuara nga subjekti, ky aspekt paraqitet më i spikatur duke nisur kryesisht nga viti 2021, kurse çështja në fjalë i përket vitit 2018, kur subjekti ende kishte ngarkesë mesatare⁴⁴. Shpjegimi i subjektit, bazuar në *prioritete* mes procedimeve, është argument evaziv dhe i pabazuar në të dhëna të mirëfillta, përpos disa referencave të saj kalimtare gjatë procesit për hetimet që ajo ka kryer për vepra penale të rënda kundër jetës, të cilat nuk janë mbështetur në dokumentacion.

11.20. Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë edhe ngarkesën mesatare të çështjeve që subjekti ka pasur në shqyrtim deri në vitin 2021, trupi gjykues i Kolegjit nuk mund të mos vërejë mungesë të aftësisë organizative të treguar nga subjekti, nën dritën e indikatorëve të pikave 2 dhe 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Sipas këtyre dispozitave, aftësitë organizative të prokurorit vlerësohen në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje. Ky vlerësim matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

11.21. Në dritën e dispozitës së sipërreferuar, për të respektuar afatet e hetimeve paraprake, *së pari*, subjekti mund ta zgjaste atë deri në dy vjet dhe pezullonte hetimet, sipas nevojës. Asnjë nga këto veprime nuk është kryer. Gjithashtu, subjekti nuk e zbatoi *menjëherë* vendimin e gjykatës, duke zvarritur procesin, me efekt cenimin e të drejtave të palëve të interesuara. Nga aktet në fashikull rezulton se nga momenti që i është njoftuar vendimi, në datën 17.12.2020, deri në kohën kur u njoh

⁴² Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 6/2024, paragrafi 29.

⁴³ https://klp.al/wp-content/uploads/2024/09/Aneksi-nr.-1-Metodologjia-e-Pikezimit-me-qellim-percaktimin-e-nivelit-te-vleresimit-i-konsoliduar.docx?cf_chl_tk=afHARvyGëAi6JD_3IxL5.Lul60uD8e2ZaU93ËX.Hhgs-1745850990-1.0.1.1-gXLXyfiETGIAKpHmL_c7898UlvM2Cmc6ËL4UbEm9ygc : dhe në faqen e KLP-së në linkun: <https://klp.al/2024/09/25/rregullorja-e-konsoliduar-per-vleresimin-etik-dhe-profesional-te-prokuroreve-dhe-aktet-shoqeruese/Aneksi-nr.-1>.

⁴⁴ Subjekti paraqiti në Komision ngarkesën e saj për periudhën 2017 – 2021. Nga këto akte rezulton se për vitin 2017, subjekti ka pasur në ngarkim 173 çështje, ndërkohë që 8 prokurorë të tjerë [nga totali i 21 prej tyre] kanë trajtuar më tepër çështje se subjekti. Edhe në vitin 2018, subjekti ka pasur ngarkesë më të ulët se 13 prokurorë të së njëjtës prokurori, pasi ajo ka trajtuar 129 çështje, ndërsa prokurorë të tjerë që kanë trajtuar dyfishin e çështjeve, nga 164 - 316. Gjatë vitit 2019, ka pasur prokurorë që kanë mbajtur ngarkesën me 345 raste, nga 128 që kishte subjekti. Në vitin 2020, nga 18 prokurorë të së njëjtës prokurori, subjekti ka pasur 192 çështje nën shqyrtim, ndërsa 12 prokurorë të tjerë, kishin çështje që varionin nga 418 në 193. Në vitin 2021, subjekti ka pasur një ngarkesë relativisht të lartë, pasi ka trajtuar 347 çështje, duke qenë e katërta prokurore me ngarkesën më të lartë.

me rezultatet e hetimit në Komision, në datën 29.04.2022, subjekti nuk kishte konkluduar për hetimet paraprake, e as zbatuar detyrat e lëna nga gjykata. Këto vonesa, të shoqëruara edhe me mungesën e hetimeve të konkretizuara edhe në orientimin e gjykatës [së apelit], u vlerësuan si mangësi të subjektit për të nxjerrë urdhra dhe për të marrë vendime, në kuptim të pikave 2 dhe 3 të nenit 73 dhe të pikave 2 dhe 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

12. Procedimi penal nr. {***/2015

12.1. Ky procedim ka për fokus një kallëzim penal të regjistruar në datën 28.07.2015, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga z. F. P. kundër shoqërisë “{***}” ShPK, për *ndërtim të paligjshëm dhe pushtim të tokës*, parashikuar nga nenet 199/a dhe 200 të Kodit Penal. Në procesin e rivlerësimit, ky procedim erdhi në vëmendje të Komisionit për shkak të tre denoncimeve⁴⁵ të znj. L. P., përfaqësuese e kallëzuesit. Znj. P. ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e subjektit nga hetimi i çështjes dhe kallëzim penal ndaj saj në ish-Gjykatën për Krimet e Rënda në vitin 2018. I ati i denoncueses është pronar i një sipërfaqeje toke prej 5.000 m² në Palasë të Vlorës⁴⁶. Sipas procedimit penal, shoqëria “{***}” ShPK, ka kryer punime pa autorizim, në kundërshtim me lejen e dhënë nga Autoritetit Rrugor Shqiptar (*në vijim “ARrSh”*) dhe ka shkatërruar pronën e saj. Gjurma e rrugës në të cilën shoqëria “{***}” ShPK po kryente punimet, sipas kontratës së lidhur me ARrSh-në, vjen në kundërshtim me gjurmën e miratuar me vendimin e datës 23.01.2013, nga Këshilli Teknik i këtij institucioni. Në Komision, denoncuesja potencon se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurores së çështjes, ka kryer hetime të *paplota* dhe tendencioze, pasi nuk fokusohet në thelbin e kallëzimit – që segmenti rrugor që ka dëmtuar pronën e saj është ndërtim pa leje – por me rrethana që lidhen me investimet në zonë.

12.2. Komisioni konkludoi se mangësitë e konstatuara në raport me ngarkesën e çështjeve të hetuara nuk janë të mjaftueshme për t’i çmuar si cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët apo një mënyrë pune e papajtueshme me funksionin e saj. Në rezultatet e hetimit, Komisioni i kishte kaluar barrë prove subjektit për: (i) gjendjen e saj në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të procesit penal të znj. P.⁴⁷; (ii) kohëzgjatjen e hetimeve; (iii) mosankimin e vendimit të pafajësisë së të pandehurve; dhe (iv) shkeljen së etikës së prokurorit, duke u larguar nga seanca.

12.3. Komisionerja Publike ka potencuar nevojën për të verifikuar nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale, të filluar në korrik 2015 dhe përfunduar me vendimin e formës së prerë në 22.08.2021, përmbushin standardet e nenit 73 pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime dhe kohëzgjatjes. Në parashtrimet e tij në Kolegj dhe në bisedimet përfundimtare, Drejtuesi i SPAK-ut konfirmoi argumentet e

⁴⁵ Përkatësisht në datat 11.01.2019, 25.11.2019 dhe 02.06.2022.

⁴⁶ Që sipas vendimit të gjykatës, këtë pronë e ka fituar në vitin 2001, me kontratën e lidhur me firmën “{***}”.

⁴⁷ Denoncuesit kanë kallëzuar subjektin për veprën penale të shpërdorimit të detyrës në cilësinë e grupit të strukturuar kriminal, për shkak të zvarritjes së procesit në bashkëpunim. Në datën 27.12.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda pranoi pjesërisht kërkesën e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se rezultojnë indicie se prokurorja Alvora ka favorizuar subjektin “{***}” ShPK, pasi fakti penal i ndërtimit të paligjshëm ishte provuar me vendimin e gjykatës civile dhe ndërsa fillimisht shmangu hetimin me vendimin për pushimin e procedimit penal, në kërkesën për pushimin e çështjes, arsyetoi mungesën e dënjësive të vendimit të Këshillit Teknik të ARrSh-së nga shoqëria “{***}” ShPK. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda e ndryshoi këtë vendim në datën 11.07.2019 dhe shfuqizoi vendimin e prokurorit për mosfillim të procedimit penal, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit dhe kryerjen e veprimeve hetimore për elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës. Në kohën kur ka marrë vendim Komisioni, kjo çështje ishte kthyer në shkallën e parë. Në fashikujt e përcjellë në Kolegj, nuk ka informacione të ecurisë së saj.

pasqyruara në ankim, duke referuar se veprimtaria e pamjaftueshme hetimore është konstatuar edhe nga gjykatat e të dy shkallëve.

12.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit të kryer në Kolegj, ka potencuar ngjashëm me kundërshtimet për rezultatet e hetimit. Konkretisht, argumentet e saj kryesisht fokusohen në dallimin në mes konceptit, që, sipas saj, përcaktohet si “kërkesa për gjykim”, që ishte akti që ajo përcolli dhe ia nënshtroi kontrollit gjyqësor dhe “kërkesës për dërgim në gjyq”, që ka qenë akti me të cilin referuar vendimit të gjyqtarit është vijuar procedimi në fjalë. Sipas saj, gjyqtari i seancës paraprake ka konstatuar për këtë të fundit. Po ashtu, sikurse edhe në Komision, subjekti ia atribuoi shkeljen e etikës gjyqtarit, duke kontestuar në tërësi rrethanat faktike të një seance gjyqësore, për të cilën ka dhënë shpjegime me barrën e provës në Komision. Në atë moment procedural, subjekti ka argumentuar edhe që nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me kallëzuesin/denoncuesen si pasojë e kallëzimit penal në ngarkim të saj, pasi nuk kishte mosmarrëveshje me këta persona. Nuk ka ankimuar vendimin e pafajësisë së dhënë nga gjykata, për arsye që lidhen me interpretimin e saj për rastet kur duhet të ushtrojë këtë mjet ligjor. Për incidentin e largimit nga seanca gjyqësore, subjekti ka parashtruar disa koncepte teorike të gjera e të përgjithshme që variojnë nga çfarë është përkufizimi i etikës gjyqësore në faktin që ajo do të ushtronte rekurs kundër vendimit të gjykatës dhe konteston rrethanat faktike, duke potencuar se u largua me lejen e gjyqtarit për të njoftuar Drejtuesin e Prokurorisë. Mungesa e etikës nuk ka qenë e saj, por e gjyqtarit të seancës paraprake. Subjekti, po ashtu, shtjellon me vëmendje të veçantë interpretimin e saj për mënyrën sesi gjykata “riartikuloi” argumentet e saj, duke pretenduar se ato *u transformuan* në kërkesa që ajo kishte zgjedhur të mos i ushtronte e që passollën që kërkesat/komunikimet me gjykatën t’i paraqiste me shkrim, për efekt qartësie dhe transparence.

12.5. Nga analiza e akteve në fashikull dhe shpjegimeve e pretendimeve të subjektit në seancë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se është i drejtë arsyetimi i Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të SPAK. Subjekti ka tejkalluar afatet, ka kryer veprime hetimore vetëm pasi është urdhëruar nga gjykata dhe pasi ka zgjedhur një linjë arsyetimi se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. *Së fundmi*, ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti në prapësimet e saj, për mospasjen detyrim të ushtrimit të ankimit, meqenëse gjykata kishte vendosur sipas kërkesës së saj fillestare, në fjalën përfundimtare në këtë çështje ka kërkuar shpalljen fajtor të të pandehurit dhe personit juridik. Këto mangësi u analizuan nën dritën e indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 për aftësinë për të ndërmarrë veprime hetimore, urdhra e vendime. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

12.6. Nga aktet në fashikull rezulton se subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, në datën 28.07.2015 mbi bazën e kallëzimit penal. Me urdhrin e datës 04.09.2015, ajo urdhëroi kryerjen e disa veprimeve hetimore. Si pasojë e këtij urdhri janë mbajtur edhe procesverbalet e pyetjeve/marrjes së të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale në katër data, mes shtatorit 2018 dhe majit 2019. Në datën 11.05.2016, subjekti vendosi pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se referuar aktit të ekspertimit të hartuar në kuadër të procesit civil me paditës kallëzuesin, ndërtimi i rrugës është bërë në përputhje me projektin e miratuar nga ARrSh-ja. Subjekti ka arsyetuar se faktet e rezultuara gjatë hetimit nuk parashikohen nga ligji si vepër penale për shkak të natyrës juridiko-civile të marrëdhënies. Subjekti, po ashtu, arsyetoi se koha e saktë e ndërtimit nuk mund të përcaktohet e nuk mund të ushtrohet ndjekja penale referuar ligjeve për amnistinë të miratuara në vitet 2012, 2014 dhe 2015. Në këto kushte, mbi bazën e nenit 328, germa “d” e Kodit të Procedurës Penale, subjekti vendosi pushimin tërësisht të procedimit për veprën *pushtimi i tokës*.

12.7. Pasi shqyrtoi ankimin e kallëzuesit kundër këtij vendimi, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, në datën 07.06.2017, ka shfuqizuar vendimin e subjektit dhe urdhëruar vazhdimin e hetimit. Gjykata ka specifikuar se prokuroria: (i) nuk kreu hetime të punimeve që kryheshin në pronën e kallëzuesit, nuk realizoi aktin e ekspertit teknik për vlerën e dëmit apo volumin e punimeve; (ii) nuk kërkoi dokumentacionin e pronësisë nga ZVRPP-ja Vlorë; (iii) nuk kërkoi nga ARrSh-ja projektin e ndërtimit; dhe (iv) nuk kërkoi vendimin e mbledhjes së Këshillit Teknik të ARrSh-së datë 23.01.2013. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, i cili u dërgua në prokurori në datën 22.01.2018.

12.8. Në datën 10.02.2018, subjekti ka vendosur të rifillojë hetimet për veprën penale të *pushtimit të tokës*. Në vijim, në datën 03.04.2018 ajo vendosi caktimin e ekspertit topografik, ndërsa në datën 8.6.2018 administroi aktin e ekspertimit të kryer në kuadër të procesit gjyqësor civil midis palëve, të përfunduar me vendimin e formës së prerë më datë 20.12.2017. Në datën 30.11.2018, subjekti iu drejtua gjykatës me kërkesë për *pushimin* e procedimit penal për veprën e *pushtimit të tokës*, pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale. Me vendimin e datës 11.03.2019, gjyqtari i seancës paraprake⁴⁸ vendosi të rrëzojë kërkesën e subjektit për *pushimin* e procedimit penal dhe e urdhëroi atë të kryejë veprime të caktuara procedurale⁴⁹. Në këtë vendim, ndër të tjera, gjyqtari i seancës paraprake arsyetoi se vepra penale e ndërtimit të paligjshëm, sipas neni 199/a/2 të Kodit Penal, është konsumuar nga shoqëria “{***}” ShPK, për shkak të kryerjes së punimeve në kundërshtim me vendimin e ARrSh-së të datës 23.01.2013, mbi sipërfaqen 610 m² të kallëzuesit. Ndërsa konstatoi, ndër të tjera, plotësinë për pjesën tjetër të hetimit dhe të provave, vendimi urdhëroi subjektin të regjistrojë emrat e personave që iu atribuohet vepra penale.

12.9. Gjykata e Apelit Vlorë e vënë në lëvizje nga subjekti, me vendimin e datës 25.06.2019, la në fuqi vendimin e shkallës së parë dhe arsyetoi se rezultoi e provuar se shoqëria “{***}” ShPK ka kryer veprime punimi/ndërtimi në kundërshtim me vendimin e ARrSh-së, datë 23.01.2013, që ndryshoi projektin fillestar të vitit 2009. Në referim edhe të vendimit të gjykatës civile të formës së prerë, datë 16.06.2016, kjo gjykatë vlerësoi se vepra penale duhet cilësuar, sipas nenit 199/a të Kodit Penal dhe vendimi i shkallës së parë duhet të lihet në fuqi. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë referohet të ketë marrë formë të prerë në datën 11.10.2019.

12.10. Subjekti ka urdhëruar rifillimin e hetimit penal në datën 17.10.2019. Në datën 01.11.2019 subjekti mori vendimet për kryerjen e veprimeve hetimore dhe të marrjes si të pandehur të shoqërisë “{***}” ShPK dhe të administratorit të saj. Në urdhrin e rifillimit të hetimit, subjekti, ndër të tjera, ka arsyetuar se, duke pasur parasysh përgjegjësinë penale të prokurorit në rast ushtrimi të padrejtë të ndjekjes penale, diskutimin për natyrën juridike të faktit t’ia shtrojë për diskutim trupit gjykues të themelit. Subjekti, po ashtu, referon pretendime të natyrës procedurale, bazuar në urdhërimin që gjyqtari i seancës paraprake i bën prokurorit në bazë të nenit 329/3/c të Kodit të Procedurës Penale, për regjistrimin e personit që i atribuohet vepra penale me fokus *nëse gjykatat kanë tejkaluar kompetencat ligjore*⁵⁰. Në datën 19.12.2019, subjekti vendosi *pushimin* e pjesshëm të çështjes për veprën penale të *pushtimit të tokës* dhe në datën 20.12.2019, paraqiti kërkesën për gjykimin e çështjes, për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm.

⁴⁸ Gjyqtari L. F., saktësuar për shkak të një situate të krijuar, lidhur me kërkesën që subjekti paraqiti për përjashtimin e tij nga gjykimi.

⁴⁹ Përfshirë formulimin e akuzës dhe marrjen si të pandehur të firmës “{***}” ShPK, për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm parashikuar nga neni 199/a/2 të Kodit Penal dhe paraqitjen pranë gjyqtarit të seancës paraprake të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, sipas urdhërimit të gjykatës.

⁵⁰ Cituar për arsye se është përdorur nga subjekti si shkak për përjashtimin e gjyqtarit të seancës paraprake.

12.11. Kjo kërkesë eventualisht i është dërguar gjyqtarit, i cili kishte qenë në ngarkim të seancës paraprake, z. L. F.. Subjekti kërkoi [në datën 05.06.2020] përjashtimin e tij me pretendimin se kërkesa për gjykimin e çështjes në gjyq nuk është pjesë e veprimeve paraprake dhe as vendimmarrje e gjyqtarit të seancës paraprake, pavarësisht se nuk kishte një vendim të gjykatës për pranimin e kërkesës për kalimin në seancë gjyqësore. Kjo kërkesë nuk u pranua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ashtu sikurse as nga Gjykata e Lartë [mbi bazën e ankimit të veçantë/rekursit të subjektit]⁵¹. Nga procesverbali i dy seancave për shqyrtimin e kërkesës për kalimin e çështjes në gjyq i datës 22.05.2022 dhe 05.06.2020, vërehet se subjekti ka kundërshtuar praninë e gjyqtarit të seancës paraprake në mënyrë verbale, duke i bërë me dije se ka paraqitur rekurs e, për këtë shkak, ai nuk mund të shqyrtonte rastin deri në vendimin e Gjykatës së Lartë. Ndërsa në seancën e datës 15.06.2020, subjekti është paraqitur me vonesë dhe [sipas procesverbalit] është larguar në mënyrë demonstrative -- element që është bërë pjesë e një hetimi disiplinor në ILD, mbi bazën e kërkesës së z. F., znj. P. dhe z. E. Ç. – Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë në atë kohë⁵².

12.12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 31.05.2021, vendosi të deklarojë të pafajshëm të pandehurin shoqërinë “{***}” ShPK dhe administratorin e saj, z. F. Gj.. Ky vendim nuk u ankimua nga subjekti dhe mori formë të prerë. Për mosankimin e këtij vendimi, gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti u shpreh se nuk pritet që prokurorët e çështjes të ankimojnë një vendim pafajësie në rrethanat si ajo konkrete –indirekt faktin që gjykata në thelb ra dakord me qëndrimin e saj fillestar, të cilin ishte detyruar ta ndryshonte me urdhër të gjyqtarit paraprak.

12.13. Nga sa më sipër, rezulton se për shkaqe të ndryshme, procedimi i këtij kallëzimi ka zgjatur për thujse gjashtë (6) vite. Në këtë periudhë kohore, veprimet hetimore dhe dosja fizikisht është disponuar e mbajtur në ngarkim të subjektit për rreth 21 muaj⁵³, pa përfshirë periudhën gjatë së cilës, për shkak të ankimeve të ushtruara prej palëve [përfshirë edhe atë vetë, në të tre shkallët], çështja ka qenë e kushtëzuar nga shqyrtimet gjyqësore të radhës. Faza e hetimeve paraprake, sikurse arsyetuar më sipër, është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistër dhe mund të zgjatet në periudha 3-mujore, por jo më shumë se dy vjet.⁵⁴ Në kushtet që kallëzimi paraqitet me emra konkretë, kundrejt personit juridik dhe administratorit, qysh në fillimet e saj, këmbëngulja e subjektit dhe zvarritja e kryerjes së veprimeve konkrete specifike për t'i dhënë një përgjigje kallëzuesve, bazuar në veprime hetimore përcaktuese e verifikuese, vlerësohet e pashpjegueshme.

⁵¹ Gjykata e Lartë nuk e pranoi rekursin e subjektit dhe, ndër të tjera, arsyetoi se: “Kështu përveç rastit të shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes, gjyqtari i seancës paraprake ka për detyrë të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq sipas nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale është e bazuar në prova dhe ligj si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë së tyre dhe vlefshmërisë së akteve. [...]. Gjithashtu e drejta e gjyqtarit të seancës paraprake për kontrollin e cilësimit juridik të faktit, si dhe formulimin e qartë dhe të saktë të akuzës është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 332/d. Në këto raste gjyqtari fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos kthimin e akteve në prokurori, duke i njoftuar këtë vendim drejtuesit të prokurorisë. Nenet 332/dh dhe 332/e përcaktojnë llojet e vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, si dhe elementet e këtij vendimi”.

⁵² Gjyqtari i çështjes, z. L. F., ka referuar ngjarjen të drejtuesi i prokurorisë, ILD-ja dhe KLP-ja, si dhe ka kërkuar marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit. Sipas shkresës, datë 04.11.2021, të ILD-së, ankesa e znj. P., E. Ç. dhe z. L. F., është miratuar për shqyrtim fillestar. Në akte nuk ka ndonjë informacion rreth ecurisë së kësaj vendimmarrje.

⁵³ Përkatësisht, çështja/dosja ka qenë e disponuar fizikisht nga prokuroria për zhvillim hetimesh më së paku në periudhat kohore korrik 2015-maj 2016, shkurt-nëntor 2018, tetor-dhjetor 2019.

⁵⁴ Neni 324 i Kodit të Procedurës Penale: “[1.] Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në gjashtë muaj. 2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. [...]”.

12.14. Në linjë me analizën e zbatuar në vijim të kallëzimit të z. M. Ç. [procedimi penal nr. {***}/2017], për arsyet përse vonesa është e paarsyeshme, edhe në rastin konkret, trupi gjykues nuk gjen arsye legjitime për zvarritjen e veprimeve hetimore. Në rastin konkret, subjekti mbartte detyrimin që të shënonte në regjistër emrin e personit që i atribuohet vepra penale⁵⁵, për të shmangur kohëzgjatje të panevojshme të procesit dhe të njoftonte edhe palët për vendime të marra për zgjatjen e afatit të hetimeve. Ndërsa pyetja e personave që kanë dijeni për veprën penale ka nisur në shtator 2015, ajo rezulton të ketë përfunduar në 4 maj 2016, pasuar nga vendimi i pushimit në 11 maj 2016, 10 muaj pas fillimit. Nga veprimet e subjektit që rezultojnë nëse mbahet në konsideratë tejzgjatja e afateve, devijimi i hetimit fillimisht vetëm në drejtim të veprës penale të pushtimit të tokës, si dhe kërkesat e subjektit për pushimin e çështjes dy herë, pavarësisht vendimit të Gjykatës së Apelit që e detyronte të vijonte hetimet, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kallëzuesit kanë krijuar perceptimin e cenimit serioz të të drejtave të tyre dhe favorizimit të të kallëzuarve, materializuar në kallëzimin penal. Me fjalë të tjera, pavarësisht se cili do të jetë vendimi përfundimtar për kallëzimin penal në ngarkim të subjektit, perceptimi i tyre, për mënyrën sesi janë trajtuar të drejtat e tyre të garantuara apo pretenduara, është aspekt me rëndësi në besimin e publikut te profesionalizmi i organeve të drejtësisë apo fenomemi i pandëshkueshmërisë.

12.15. Po ashtu, trupi gjykues vëren se mënyra sesi subjekti e relativizon rrjedhën e veprimeve, duke nxjerrë në pah mënyrën *si e shikon procesin*, në kushtet që në diskutim janë afatet e hetimeve paraprake të shpërfillura apo kohëzgjatjet pa veprime hetimore dhe devijimet e hetimit, edhe pasi gjykatat i kanë dhënë një këndvështrim e orientim për veprimet që duhen kryer, sikurse arsyetuar edhe më sipër, tregon një vijë sjelljeje të përsëritur e të papranueshme. Me vendim të Gjykatës së Apelit, çështja i është kthyer subjektit dy herë për plotësim të hetimeve. Për gjithë sa më sipër, me veprimet e saj, subjekti ka cenuar të drejtën e palës së dëmtuar për drejtësi në një kohë të arsyeshme. Në vlerësim të trupit gjykues, këto aspekte tregojnë mangësi organizative dhe që subjekti nuk është efektive më së paku.

12.16. Subjekti ka treguar edhe mangësi në interpretimin e ligjit, pasi në çështjen konkrete ka vendosur të pushojë procedimin vetëm për veprën penale të *pushtimit të tokës*, pa u shprehur për fatin e procedimit për ndërtimin e paligjshëm apo arsyet për të cilat nuk e analizoi këtë veprë penale, ndërkohë që fakti penal i ndërtimit të paligjshëm ishte provuar me vendimin e gjykatës civile, dhe prokuroria kishte për detyrë të provonte fajësinë ose pafajësinë⁵⁶. Sipas rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë⁵⁷, në zbatim të nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, një ndër elementet që mbahet në konsideratë për vlerësimin e prokurorëve është edhe aftësia për të argumentuar dhe analizuar, në aspektin e cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik, si pjesë e aftësisë për arsyetimin ligjor.

12.17. Për sa i përket sjelljes së subjektit në seancën gjyqësore të datës 15.06.2020, pavarësisht dhe duke abstraguuar nga interpretimet alternative të dhëna prej saj, trupi gjykues i Kolegjit vëren se largimi i saj nga seanca përbën shkelje të etikës profesionale dhe të solemnitetit të gjykimit. Prokurori/ja kanë detyra specifike të përcaktuara nga Kushtetuta e ligjet për të ushtruar ndjekjen penale në emër dhe për llogari të interesit publik dhe atij të individëve. Largimi i subjektit nga seanca, përpos dëmit që sjell për imazhin e autoritetit të procesit gjyqësor, cenon të drejtat e palëve në proces. Shpjegimet e subjektit, në Komision, se termi “etikë” ka të bëjë me atë që thua dhe atë

⁵⁵ Sipas vendimit unifikues nr. 3/2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁵⁶ Referuar konstatimit të Gjykatës së Apelit më 25.05.2019 dhe më pas edhe Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

⁵⁷ <https://klp.al/wp-content/uploads/2022/10/tabela-rregullore.pdf>

që bën, dhe se ajo bëri atë që tha, janë të pakuptimta dhe u vlerësuan pa asnjë peshë në analizën tërësore të rrethanave që rezultojnë.

12.18. Në përmbledhje të sa më sipër, të gjitha aspektet e sjella në vëmendje që kanë rezultuar nga aktet u bënë pjesë e vlerësimit të kryer nga trupi gjykues në proces për efekt të zgjidhjes së çështjes. Subjekti ka treguar mangësi në drejtim të aftësive për të hetuar, për të nxjerrë urdhra, si dhe mangësi në drejtim të aftësive organizative, në drejtim të respektimit të afateve ligjore, sipas pikës 2 të nenit 73 dhe të pikave 2 dhe 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Subjekti nuk ka arritur të përmbys barrën e provës së kaluar nga Komisioni për konstatimet në procedimin në fjalë.

13. *Kallëzimi penal nr. {***}/2015*⁵⁸

13.1. Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij procedimi të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit nga denoncimi i paraqitur nga z. G. S.. Konkretisht, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë 23.02.2015, regjistroi kallëzimin penal të këtij individi për veprat penale, të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Kallëzuesi shprehet se ka ndërtuar një shtëpi pa leje në zonën e Ujit të Ftohtë, në Vlorë, në vitin 1998, ku jetoi deri në vitin 2005. Për këtë banesë, kallëzuesi kishte aplikuar për leje legalizimi në datën 10.02.2005. Në vitin 2005, z. S. kontaktoi me një person [z. K. Ll.], qiramarrës i një objekti që ndodhej në pjesën perëndimore të banesës së tij, nga i cili u informua se objekti pranë shtëpisë së tij ishte shitur, ndërsa mbi truallin e shtëpisë së z. S. do të ndërtohej një pallat. Në këmbim, kallëzuesi do të merrte një garsoniere. Sikurse referohet në vendimin e gjykatës nr. {***}/2019, kallëzuesi/denoncuesi nuk ka rënë dakord me këtë propozim. Nga aktet e ZVRPP-së Vlorë, pasuria që z. Ll. bleu nuk kishte asnjë lidhje me banesën e z. S.. Pas premtimit se do të përfitonte një banesë, z. S. lejoji prishjen e shtëpisë së tij, ndërsa premtimi nuk u materializua. Duke krijuar bindjen se është mashtruar, ai paraqiti kallëzim penal.

13.2. Në vendim, Komisioni analizoi se, duke qenë se kjo çështje është ende në shqyrtim, gjen zbatim ndalimi i vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në përputhje me pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Duke mbajtur në konsideratë afatin 5-vjeçar, Komisioni ia kaloi për shqyrtim çështjen ILD-së. Më herët, në rezultatet e hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për: (i) moskryerjen e veprimeve hetimore brenda kohës së vendosur nga gjykatat për hetimet shtesë; dhe (ii) moskryerjen e hetimeve të plota referuar vendimeve të gjykatave në mënyrë të përsëritur, pretendim i ngritur edhe nga denoncuesi/kallëzuesi.

13.3. Komisionerja Publike kërkon që sa referohet në këtë denoncim për veprimet e subjektit t'i nënshtrohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, praktikat që transferohen për inspektim duhet të përmbajnë shkëlqje *joserioze*, pa pasoja të rënda procedurale për palët, brenda afateve të parashikuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016. Në një vlerësim tërësor të çështjes, rasti objekt ankimi paraqet situata të cilat, shoqëruar dhe me një hetim të mangët, nuk justifikojnë vlerësimin pozitiv të kriterit profesional. Përsëritja e gabimeve dëshmon mangësi profesionale. Po ashtu, Komisionerja potencon se çështja nuk është në shqyrtim⁵⁹, pasi subjekti është

⁵⁸ Kallëzuesi, z. G. S., ka paraqitur denoncim edhe në Kolegj për subjektin e rivlerësimit dhe lidhet me rastin e shqyrtuar në Komision e të ankimuar nga Komisionerja Publike.

⁵⁹ Vendimi i Kolegjit nr. 28/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Fuat Vjerdha, paragrafi 14.7 “Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: “[...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim. [...] do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë”.

shprehur disa herë, si detyrim nga vendimmarrja e gjykatave përkatëse, në harkun kohor prej vitit 2015 e deri në korrik të vitit 2021. Shqyrtimi gjyqësor i rastit do të evidentonte veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit që kanë ndikuar në mungesën e hetimeve, vonesat e tejzgjatura kohore dhe përfundimit të hetimit penal, si dhe mosrespektimin në kohë të detyrave të lëna nga gjykata. Drejtuesi i SPAK-ut, duke konfirmuar sa referohet më sipër, ka argumentuar se rrethanat e konstatuara nga analiza e veprimeve të subjektit evidentojnë mangësi të kriterit të vlerësimit profesional, sipas nënindikatorëve të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, për mangësi veprimesh hetimore e konfirmuar nga gjykatat e dy shkallëve.

13.4. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet në seancën publike në Kolegj, u fokusua në parashkrimin e ndjekjes penale dhe në veprimin në kohë të ligjit që normonte situatën, duke theksuar se kallëzimi dhe procedimi i përkisnin përkatësisht vitit 2015 dhe 2017, ndërsa veprimet datonin në vitin 2005. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti argumentoi edhe që denoncuesi mori përgjigje nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nëpërmjet të cilës u orientua t'i drejtohet gjykatës për zgjidhje. Denoncuesi iu drejtua Prokurorisë rreth 10 vjet më vonë ndërkohë që ligji për legalizimin i përket vitit 2006 e, për pasojë, nuk mund të ketë efekt prapaveprues për veprime ekzekutimi të kryera në vitin 2005 [për prishjen e një objekti të ndërtuar pa leje], çfarëdo hetimi të kryhet për shpërdorim detyre. Subjekti shpjegoi se në çështjen në fjalë, në thelb, është operuar vetëm me funksionin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, që nuk ka afat të përcaktuar, pasi ushtrimi i ndjekjes penale ishte parashkruar.

13.5. Nga analiza e akteve në fashikull dhe shpjegimeve e pretendimeve të subjektit në seancë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se është i drejtë arsyetimi i Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të SPAK. Subjekti ka tejkaluar afatet dhe vetëm pasi është urdhëruar nga gjykatat ka kryer veprime hetimore. Ndonëse eventualisht gjykata ka rënë dakord me qëndrimin e saj paraprak, kjo ka qenë pasojë e hetimit të thelluar për vërtetimin e faktit të vënë në diskutim. Këto mangësi u analizuan nën dritën e indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, për aftësinë për të ndërmarrë veprime hetimore, urdhra e vendime. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

13.6. Nga aktet rezulton se kallëzimi është regjistruar në datën 23.02.2015. Një muaj më pas, më 24.03.2015, subjekti i rivlerësimit vendosi mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin që: (i) kallëzuesi nuk specifikoi cili ishte dokumenti i pretenduar i falsifikuar; dhe (ii) nuk ka vend për hetim të veprës penale të mashtimit, pasi kallëzuesi ishte në dijeni të procedurave dhe kjo çështje rregullohej nga kuadri juridik civil. Në vijim, gjykatat e të dy shkallëve, vënë në lëvizje nga kallëzuesi me ankim, disponuan përkatësisht për të lënë në fuqi vendimin e prokurores/subjektit dhe ndryshimin e vendimit dhe vijimin e hetimeve, në datat 11.11.2015 dhe 26.07.2017. Konkretisht, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë konstatoi se vendimi për prishjen e objektit është marrë në datën 02.09.2004 dhe u pranua mosfillimi, Gjykata e Apelit Vlorë shfuqizoi vendimin e mosfillimit të procedimit penal me arsyetimin se të kallëzuarit nuk ishin të sinqertë me kallëzuesin dhe shpërdoruan besimin me anë të premtimit/gënjeshtërisë, duke konsumuar kështu elementet e veprës penale të “*Mashtimit*”. Organi i akuzës kishte detyrimin të hetonte për të sqaruar marrëdhënien midis palëve, ashtu edhe rrethanat e prishjes së banesës, miratimin e lejes së ndërtimit dhe zbatimin e saj.

13.7. Në vijim të sa më sipër, më datë 16.10.2017, subjekti urdhëroi regjistrimin e procedimit penal [nr. {***} të vitit 2017] për veprën penale të “*Mashtimit*”. Deri në këtë moment, subjekti nuk është shprehur për parashkrimin e veprës penale. Në datat 18.10.2017 dhe 14.02.2018, subjekti edhe ka deleguar kryerjen e veprimeve hetimore tek OPGj-ja, përfshirë pyetjen e personave, këqyrjen e

vendimit të ngjarjes, administrimin e të dhënave nga ZVRPP-ja dhe ALUIZNI. Në fashikuj gjenden akte që tregojnë kryerjen e disa veprimeve hetimore për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve, datë 14.05.2018, si dhe disa procesverbale të mbajtura nga OPGj-të përgjatë vitit 2017 dhe 2018, në lidhje me pyetjet dhe marrje të dokumenteve të kësaj çështjeje.

13.8. Në datën 23.11.2018, subjekti i rivlerësimit kërkoi *pushimin* e procedimit penal, duke argumentuar se regjistrimi u krye pavarësisht ndalimit ligjor për shkak të *parashkrimit*. Gjyqtari i seancës paraprake, me vendimin nr. {***}, datë 05.02.2019, vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit dhe kryerjen e veprimeve të caktuara [administrim aktesh dhe ballafaqimin, ndër të tjera], brenda dy muajve nga marrja e formës së prerë të atij vendimi. Gjyqtari, ndër të tjera, shprehet se prokuroria nuk ka përmbushur të gjitha detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë. Në vijim, subjekti ushtroi ankim. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendim të datës 26.03.2019, la në fuqi vendimin e shkallës së parë, pasi vlerësoi se prokuroria nuk ka kryer veprime hetimore që janë thelbësore për të vendosur procedimin e mëtejshëm të çështjes.

13.9. Subjekti ka *rifilluar* hetimin e procedimit penal në datën 02.05.2019 dhe në datën 02.06.2020 i është drejtuar *sërish* Gjykatës me kërkesën për *pushimin* e procedimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë konstatoi *sërish* mungesë hetimesh dhe, duke i vlerësuar të drejta kërkesat e kallëzuesit, me vendimin nr. {***}, datë 02.06.2021, urdhëroi vazhdimin e hetimeve, me veprime të detajuara në pjesën arsyetuese. Sipas gjykatës, përfundimi i organit të prokurorisë se nuk provohet kryerja e veprës penale, u nxor mbi bazën e një hetimi jo të plotë në lidhje me faktin penal. Ndër të tjera, apeli arsyeton se argumentet e paraqitura në ankim, që lidhen me aktin e ekspertimit topografik apo ato që lidhen me fuqinë ligjore të ligjit të legalizimit në momentin e prishjes së ndërtesës, nuk qëndrojnë, përderisa gjykata e faktit ka lënë detyra konkrete për t'u realizuar gjatë vazhdimin të hetimeve. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim kundër vendimit të mësipërm të gjykatës në datën 30.07.2021, duke argumentuar se gjykata nuk e ka lexuar fashikullin hetimor dhe se vendimmarrja nuk është produkt i provave të administruara. Po ashtu, subjekti parashtroi se prokuroria i ka kryer veprimet për të cilat është urdhëruar nga gjykata⁶⁰. Gjykata e Apelit Vlorë, më datë 14.10.2021, la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke konstatuar edhe në këtë rast se hetimet nuk janë plotësuar, pasi nuk është administruar CD-ja me pamjet filmike nga një televizion, si dhe që veprimi hetimor i kryer nga prokuroria nuk ishte shterues për të arritur në konkluzionin se nuk ka veprë penale. Ky vendim mori formë e prerë në datën 30.08.2022.

13.10. Përfundimisht, pasi çështja i ka kaluar një prokurori tjetër, i cili ka kryer disa veprime hetimore, çështja ka pushuar për shkak të *parashkrimit*. Në datën 24.02.2025, gjykata ka konstatuar se është kryer vepra penale e mashtrimit, por ndjekja penale nuk mund të vijojë për shkak të *parashkrimit*, pasi kanë kaluar mbi 10 vjet nga kryerja.

13.11. Sikurse arsyetuar më sipër, nuk gjen zbatim ndalimi i parashikuar nga pika 2 e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, për vlerësimin. Subjekti ka mbajtur qëndrime të përsëritura dhe tashmë përfundimtare. Në momentin kur ankimi u shqyrtua në Kolegj, për më tepër, çështja ishte pushuar dhe kishte edhe një vendim gjykate që konfirmonte *pushimin* e saj – referuar në paragrafin më sipër. Argumentimi i Komisioneres Publike, për natyrën *joserioze* të çështjeve që Komisioni mund të

⁶⁰Subjekti specifikon në kërkesë që: “Vendimi për prishjen nuk është kundërshtuar nga kallëzuesi në vitin 2005, M. L. është pyetur më parë, ka rënë interesi publik për ndjekjen e çështjes pasi është parashkruar vepra penale, dhe gjykata kërkon kryerjen e hetimeve përtej afatit të përcaktuar në nenin 66 të Kodit Penal, prokuroria i ka kryer veprimet pa të cilat gjykata nuk mund të marrte një vendim për çështjen. Informacioni mund të aksesohet në internet, dhe administrimi i CD-së është kushtëzuar nga autorizimi për publikim nga kallëzuesi”.

dërgojë për inspektim në ILD, është i drejtë⁶¹. Premisa e gabuar, sipas së cilës Komisioni ka nxjerrë jashtë rivlerësimit këtë çështje, për shkak të interpretimit të pabazuar në ligj dhe në rrethanat konkrete faktike, ka passjellë, ndër të tjera, edhe mosnënshtrimin e kësaj çështjeje juridiksionit rivlerësues.

13.12. Nga ana tjetër, vendimi objekt ankimi, nëpërmjet të cilit Komisioni disponoi edhe për transferimin e kësaj dosjeje për inspektim në ILD, mban datën 07.06.2022. Në kushtet që subjekti ka marrë pesë (5) herë vendime/urdhra për efekt të këtij procedimi penal, në harkun kohor nga *marsi 2015 deri në qershor 2019*, transferimi i kësaj dosjeje për inspektim pranë ILD-së sjell në diskutim afatin 5-vjeçar të hetimit për shkeljet e pretenduara, për shkak të parashkrimit sipas nenit 117 të ligjit nr. 96/2016. Sipas kësaj dispozite, kur ankesa paraqitet pas 5 vitesh, ashtu si edhe në rastin kur vetë ILD-ja ka të dhëna nga hetimi kryesisht, nuk e fillon hetimin. Në këto kushte, çmohet i drejtë pretendimi Komisioneres Publike se transferimi i çështjes për shkak të mosveprimeve të subjektit që janë konstatuar nga gjykata me vendimin e shkallës së parë, të vitit 2017 dhe të apelit të vitit 2019, për një kallëzim të vitit 2015, për shkak të kalimit të afatit 5-vjeçar të kryerjes së shkeljeve [potenciale], mbetet pa vlerësim dhe sjell si pasojë mënjanimin e vlerësimit të subjektit sipas ligjit nr. 84/2016.

13.13. Duke iu rikthyer themelit të veprimeve të subjektit në këtë procedim, problematikat që evidentohen janë të ngjashme me çështjet e tjera të analizuar më sipër. Subjekti ka tejzgjatur afatet e hetimit, ashtu sikurse edhe në mënyrë të përsëritur tregon mospërfillje të detyrave të lëna nga gjykatat. Konkretisht, nga momenti që Gjykata e Apelit Vlorë vendosi të prishë vendimin e mosfillimit të procedimit penal në datën 16.10.2017, deri më së paku në datën 05.02.2019, ende nuk kishte plotësuar veprime të caktuara hetimore, sikurse rezulton nga vendimi gjyqësor që edhe caktoi afatin dymujor. Pas ecejakeve të përsëritura mes ankimeve dhe urdhërimit nga Gjykata e Apelit Vlorë në datën 26.03.2019, kishte veprime hetimore ende të pakryera më së paku deri në *qershor të vitit 2021*. Ndërsa subjekti në proces shprehet për efektin që kishte parashkrimi i ndjekjes penale, në veprimet e saj nuk rezulton orientimi në atë drejtim arsyetimi deri në nëntor 2018. Po ashtu, subjekti ka munguar t'i ketë dhënë përgjigje pyetjes nëse ka ndodhur mashtrimi i pretenduar nga kallëzuesi. Këtë fakt për herë të parë kallëzuesi rezulton ta ketë konfirmuar nëpërmjet veprimeve të prokurorit tjetër dhe vendimin e gjykatës që konfirmoi vendimin e pushimit në vitin 2025.

13.14. Për aq sa konstatohet nga aktet në dosje, subjekti kreu tetë veprime hetimore për 4 vite, që konsistuan në kërkesa për informacione në IMT dhe ZVRPP dhe pyetjen e personave të përfshirë në ngjarje. Subjekti nuk rezulton të ketë urdhëruar kryerjen e ekspertimit topografik. Në pikën fundore, thuhet gjithë veprimet hetimore janë pasojë e urdhrave konkrete të gjykatave, që gjithsesi subjekti i ka ankimuar me arsyetime të cilat duket se përçojnë në thelb mospërfilljen e këndvështrimit të mënyrës së hetimit që rezulton nga vendimet e gjykatës. Në ankimin e datës 15.02.2019, ndër të tjera, subjekti kundërshton vendimin e gjykatës që e ka urdhëruar disa veprime hetimore, me pretendimet se vijimi i mëtejshëm i hetimit do ta shndërronte prokurorinë në një institucion që kryen veprime për individët privatë, duke e penguar kështu vijimin e veprimtarisë së mëtejshme (referuar ngarkesës së punës në prokurorinë dhe numrit të prokurorëve që po ushtrojnë

⁶¹ *Neni 59, parashikon: "[4.] Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim. [...]"*

detyrën) apo që ballafaqimi mes kallëzuesit e të kallëzuarit në vitin 2015 nuk do të sillte asnjë dobi për hetimin⁶².

13.15. Për këto arsye, zgjatja në mënyrë të pajustificuar e hetimeve paraprahe për thujse gjashtë (6) vjet, përtej afatit maksimal të përcaktuar nga ligji prej dy vjetësh⁶³, cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, e ardhur si pasojë e sjelljes së autoritetit/prokurorit. Ankimi tri herë për të njëjtin shkak dhe moszbatimi i përsëritur i vendimeve të gjykatës ka sjellë pasoja për palët e interesuara.

13.16. Për themelin, subjekti bazohet në zbatimin e ligjit në kohë, duke argumentuar bazuar në faktin që ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ka hyrë në fuqi në vitin 2006, ndërsa veprimet e pretenduara të paligjshme të policisë ndërtimore dhe IMT-së i përkasin vitit 2005 [sipas saj]. Trupi gjykues vëren se në vitin 2005 kanë qenë në fuqi dy ligje të tjera pararendëse të ligjit nr. 9482/2006⁶⁴. Për rrjedhojë dhe çfarë është më e rëndësishme, pavarësisht nga baza ligjore që mund të potencojë a identifikojë një kallëzues, subjekti ishte e detyruar të identifikonte saktë veprën penale dhe ligjin e zbatueshëm. Ligji nr. 9304/2004, që ishte në fuqi në kohën kur pretendohet se janë kryer veprimet nga policia ndërtimore, parashikonte në nenin 2 për banesat që prisheshin për shkak të zbatimit të projekteve të zhvillimit urbanistik, pronarëve iu mundësohej vënia në dispozicion e parcelave të lira ndërtimore nga njësia e qeverisjes vendore. Ky parashikim ligjor i kohës krijonte detyrimin e subjektit për verifikimin e ligjshmërisë së kryerjes së veprimeve nga organet kompetente, përkundrejt kallëzuesit për të krijuar qartësinë që nevojitej në mënyrë që ai të merrte zgjidhjen eventuale. Sikurse ka konstatuar gjyqtari i seancës paraprahe, pavarësisht kalimit të afateve kohore të parashkrimit të ndjekjes penale, organi i akuzës duhet të kishte kryer hetimet përkatëse për të konkluduar nëse ekziston fakti penal, për efekt edhe të mundësimin të zgjidhjes së problemit të parashtruar nga kallëzuesi nëpërmjet organeve të qeverisjes vendore.

13.17. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit vëren se aspektet e analizuara tregojnë mangësi të subjektit të rivlerësimit për të ndërmarrë hetime, urdhra, vendime dhe interpretuar saktë normën ligjore, të kryera në mënyrë të përsëritur dhe për periudha të gjata kohë, indikatorëve të vlerësimit profesional të prokurorëve, parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Elemente të tillë, si zvarritja/zgjatja pa shkaqe të arsyeshme/justifikuara të hetimeve të hetimeve paraprahe, të respektimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga momenti i kallëzimit deri në marrjen e një vendimi, dhe moszbatimi i urdhërimeve të gjykatës, që e kthejnë çështjen për plotësim të hetimeve në mënyrë të përsëritur, u mbajtën në konsideratë si elementë që përveçse tregojnë mangësi të subjektit në drejtim të aspektit organizativ, kanë pasur efekt cenes të të drejtave të palëve në proces.

14. Kallëzimi penal nr. {***}/2019

14.1. Denoncuesi, z. I. Z., me profesion avokat dhe përkthyes i licencuar, paraqiti denoncim në Komision, ILD, Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Rrethit, ndaj subjektit të rivlerësimit për

⁶² Ndër të tjera, në ankimin e datës 15.02.2019 kundër vendimit gjyqësor [nr. {***}, datë 05.02.2019], subjekti shprehet edhe që: (i) urdhërimi i gjykatës që të administrojë praktikën e IMT-së, nuk mund të realizohet. Subjekti shtron pyetjen se si do të kryhet ky veprim – duke inventarizuar gjithë arkivën e IMT-së, dhe a mund ta bëjë referuar legjislacionit në fuqi; (ii) për kryerjen e aktit të ekspertimit topografik, është veprim që përbën plotësim të një vendimi të marrë më parë nga Gjykata e Apelit, Vlorë, kur prishi vendimin e mosfillimit të procedimit penal, plotësimi i një vendimi të dhënë nga gjykata më e lartë, dhe që “nuk mund të bëhet nga një gjykatë më e ulët në një moment të dytë”.

⁶³ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 42/2024, cituat në poshtëshënimin nr. 42 më lart.

⁶⁴ Ligji nr. 9304/2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale” dhe ligji nr. 9209/2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”. Këto ligje, më vonë u kombinuan në përmbajtje nëpërmjet ligjit nr. 9482/2006.

tri çështje të ndjekura prej saj. Ai potencon se subjekti ka treguar neglizhencë dhe papërgjegjshmëri në kryerjen e detyrës, nëpërmjet: (i) moskryerjes së asnjë veprimi hetimor për të cilin zgjat afatin për secilën dosje; (ii) moskryerjes së hetimit të thelluar për të siguruar prova; (iii) mungesës së analizës në akte, për të zbardhur të vërtetën; dhe (iv) shmangie nga funksioni i një prokuroreje të pavarur në përmbushje të detyrës funksionale. Konkretisht për⁶⁵:

(i) Procedimin penal nr. {***}/2019 ({***}/2020), që lidhej me një kallëzim të z. F. H. për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve – bërë pjesë e ankimit të Komisioneres Publike. Denoncuesi ankohet se me veprimet dhe mosveprimet e saj, subjekti jo vetëm “minoi” dosjen e hetimit, por edhe rrezikon parashkrimin e veprës penale me kundërshtimet procedurale që kreu. Në denoncim, parashtrihen problematika të mungesës së eficiencës profesionale e praktike, pasi subjekti nuk ka kryer një veprim, i cili i është urdhëruar dy herë nga Gjykata e Apelit Vlorë, duke qenë në kushtet e veprës penale të mosushtrimit të funksioneve të saj.

(ii) Për çështjen penale nr. {***}/2015, denoncuesi parashtron se subjekti cenoi mbrojtjen efektive duke caktuar avokat kryesisht, pasi nuk i krijoi mundësinë që të njihej me aktet e dosjes penale.

14.2. Pasi hetoi për këto pretendime, Komisioni konstatoi njësoj me çështjen e kallëzimit penal të sipëranalizuar [nga z. G. S., kallëzimi nr. {***}/2015], duke arsyetuar se flitet për çështje nën shqyrtim nga subjekti e, për pasojë, gjen zbatim ndalimi nga pika 2 e nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Përfundimisht, Komisioni ia përcolli pretendimet e denoncuesit ILD-së. Përkundër këtij konkluzioni, në rezultatet e hetimit, Komisioni kishte konstatuar: (i) veprime dhe mosveprime të subjektit që ndikuan në zvarritje të pajustificuar të gjykimit të çështjes; (ii) përsëritjen e sjelljes së subjektit në mungesën e kryerjes së hetimeve të plota; (iii) edhe pas urdhërimeve të Gjykatës së Apelit, dy herë nuk i dha zgjidhje procedimeve për periudha të gjata kohore; (iv) vonoi në mënyrë të pamotivuar rezultatin e hetimit dhe nuk kreu menjëherë verifikimet e mundshme.

14.3. Komisionerja Publike, në linjë me çështjen tjetër, argumenton se procedimi penal nr. {***}/2019, nuk duhet të nxirrej jashtë juridiksionit rivlerësues, pasi paraqet situata, të cilat të marra së bashku, shoqëruar dhe me një hetim të mangët, ndikojnë pozitën e subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit profesional, duke mosjustifikuar konfirmimin në detyrë. Subjekti nuk tregoi efektivitet në hetim dhe nuk e përmbysi barrën e provës. Mosrespektimi i autoritetit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit ka sjellë zvarritje të panevojshme të hetimit të çështjes, në drejtim të cenimit të të drejtave dhe interesat e qytetarit kallëzues. Sipas analizës së Komisioneres Publike, vetëm në datën 11.03.2022, pra, gati 1 vit pas dhënies së vendimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka kërkuar dorëzimin e fashikullit dhe vendimin përkatës nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Duke konfirmuar sa më sipër, në procesin e zhvilluar në Kolegj, Drejtuesi i SPAK-ut u shpreh se mangësitë në formën e veprimeve hetimore të pamjaftueshme, konstatuar në këtë çështje, evidentuar edhe nga gjykatat e të dy shkallëve, duhet parë sipas nënindikatorëve të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

14.4. Në seancën gjyqësore në Kolegj, subjekti argumentoi se mosfillimi i hetimit ka qenë veprim i drejtë, pasi asnjë nga veprimet hetimore nuk e ka ndryshuar gjendjen dhe që kohëzgjatja e procesit i atribuohet pjesërisht faktit që ajo ka marrë fashikullin vetëm në mars 2022, ndërsa vendimi i Gjykatës së Apelit ishte dhënë më parë dhe ankimi i ushtruar datonte në nëntor 2020. Edhe në përgjigje të barrës së provës, subjekti pretendoi në të njëjtën linjë, duke u shprehur se kalimi dhe

⁶⁵ Av. I. Z. ka paraqitur ankim edhe për një procedim tjetër që lidhej me çështjen penale të nisur në vitin 2013, që i përket z. S. Xh., por nuk është bërë pjesë e ankimit të Komisioneres Publike.

mbajtja e kopjeve të akteve nuk është përgjegjësi e saj dhe vuri në dyshim bazueshmërinë e qëndrimit të prokurorit të apelit, në kushtet kur një gjyqtar e ka konsideruar të drejtë vendimmarrjen e prokurorit të çështjes. Subjekti përcolli në Komision shkresën e datës 10.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilën janë dërguar fashikujt e hetimit. Subjekti urdhëroi rifillimi i hetimit paraprak, më datë 17.03.2022 dhe arsyetoi se vendimi nr. {***}, datë 16.03.2021, i Gjykatës së Apelit Vlorë, saktësoi se diskrecioni i mëparshëm për kryerjen ose jo të aktit të ekspertimit, sipas vendimit të kësaj gjykate (Gjykatës së Apelit Vlorë) nr. {***}/2019, nuk ekziston, pasi është urdhërim.

14.5. Nga analiza e akteve në fashikull dhe parashtrimeve të palëve në seancë, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se pretendimet e Komisioneres Publike, konfirmuar nga Drejtuesi i SPAK-ut, gjatë seancës publike në Kolegj, janë të bazuara edhe në këtë çështje. Subjekti ka treguar mangësi të së njëjtës natyrë, sikurse edhe ato të evidentuara edhe më sipër edhe në ndjekjen e kësaj çështjeje, me pasoja për të drejtat e palëve. Edhe në këtë procedim, subjekti ka treguar mospërfillje të udhëzimeve konkrete të gjykatës, ndërsa disa prej veprimeve hetimore kyçe, pas urdhrave të përsëritur, janë kryer vetëm në maj 2022, ndonëse ishin urdhëruar nga Gjykata e Apelit që në dhjetor 2019. Pavarësisht se një pjesë e vonesave nuk mund t'i atribuohen subjektit, disa prej zvarritjeve rezultojnë si pasojë e zgjedhjeve të saj për të mos u investuar në përfundimin e çështjeve bazuar në të dhëna të prodhuara nga hetimi, edhe pasi i është mundësuar orientim për mënyrën e procedimit në mënyrë të përsëritur nga gjykatat. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

14.6. Kallëzimi penal në fjalë rezultoi të jetë regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë 02.07.2019. Kallëzuesi [z. F. H.] ka pretenduar kryerjen e dy veprave penale, “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Pastrim i produkteve të veprës penale”, nga një person i caktuar [znj. F. V.]. Problematika e kallëzimit lidhet me një sipërfaqe prone në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë, e cila ka mbivendosje me një pronë tjetër me sipërfaqe 6.100 m². Zanafilla e problematikës së kallëzuar është një vendim i vitit 1995 i Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave Vlorë (në vijim “KKKP”), i cili, sipas kallëzuesit, është bërë objekt falsifikimi. Saktësimi i sipërfaqeve/pozicioni në terren është bërë me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vitin 2002 dhe lënë në fuqi nga gjykatat më të larta. Kallëzuesi pretendoi se vendimi i KKKP-së nuk është autentik, pasi nuk ka përcaktim të saktë kufijsh dhe se një pjesë e pronës është trajtuar si pronë e kallëzuesit nga një vendim i mëparshëm me nr. {***}/1995, i KKKP-së Vlorë.

14.7. Në datën 17.07.2019, subjekti i rivlerësimit vendosi *mosfillimin* e procedimit, duke konstatuar se faktet nuk përbëjnë veprë penale dhe pretendimet e kallëzuesit janë për saktësim kufijsh e, për pasojë, me natyrë administrative. Po ashtu, subjekti argumenton se pretendimet që lidhen me falsitetin e vendimit nr. {***}/1995, të KKKP-së Vlorë, nuk qëndrojnë, pasi ky institucion pranon në mënyrë zyrtare të ketë lëshuar vendimin e kundërshtuar si të falsifikuar, nëpërmjet ankimeve të paraqitura në gjykatë. Në kuadër të hetimeve, subjekti kishte administruar kopje të dosjes gjyqësore të vendimit të vitit 2002 dhe pyeti kallëzuesin. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e vënë në lëvizje nga kallëzuesi, me vendimin nr. {***}, datë 08.10.2019, la në fuqi vendimin e subjektit, me të njëjtin arsyetim. Ky vendim u ndryshua nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 10.12.2019, [kërkuar edhe nga prokurori i apelit], pasi konstatoi mungesë të hetimit nga prokuroria dhe urdhëroi regjistrimin e procedimit penal për *falsifikim i dokumenteve*, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Kjo gjykatë, ndër të tjera, arsyetoi se nuk u administrua si provë kopja e dosjes së vendimit nr. {***}/1995, të KKKP-së Vlorë, nga institucioni që e ka nxjerrë procesverballi i mbledhjes apo protokolli. Gjithashtu, prokuroria nuk hetoi në lidhje me ekzistencën e vendimit të

organit administrativ që *suksedoi* ish-AKKP-ja Vlorë, dhe se argumenti i prokurorisë që ky organ nuk mohoi ekzistencën e vendimit është i mbështetur në deduktime, jo në pohime të mirëfillta. Për më tepër, kallëzuesi ngriti edhe pretendime që lidhen me elemente të falsifikimit të aktit [ndryshime grafike] dhe shtoi në arsyetim se kryerjen e akt *ekspertimit grafik, në rast se vlerësohet e nevojshme*, si dhe administrimin e akteve të tjera hetimore, sipas vlerësimit të prokurorisë. Vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë në datën 08.05.2020 dhe i është dërguar Prokurorisë në datën 13.05.2020.

14.8. Në datën 20.05.2020, subjekti urdhëroi regjistrimin e procedimit penal, ndërsa në datën 20.07.2020 ajo urdhëroi kryerjen e veprimeve hetimore nga OPGj-ja. Në datën 27.11.2020, subjekti paraqiti kërkesë për pushimin e çështjes në gjykatë, me të njëjtin arsyetim, si edhe në vendimin e mosfillimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 26.01.2021, vendosi *mospranimin* e kërkesës për pushimin e procedimit penal dhe kthimin e akteve për të kryer aktin e ekspertimit dhe veprimeve të tjera hetimore të nevojshme, për të vijuar më tej qoftë me kërkesë për pushim apo formulim akuze dhe dërgim të çështjes në gjyq. Gjykata, ndër të tjera, shprehet se pavarësisht se në dosjen gjyqësore të vendimit të vitit 2002, ndodhen dy kopje të vendimit nr. {***}/1995, prokurori duhet të kryejë aktin ekspertimit për përmbajtjen dhe nënshkrimet brenda afatit *dymujor*. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim ndaj këtij vendimi, me arsyetimin se vendimi nr. {***}/1995 u administrua dhe ekspertimi do të përbente provë *haptazi të panevojshme*, sipas nenit 151 të Kodit të Procedurës Penale⁶⁶, pasi dokumenti që pretendohet i falsifikuar është pohuar dhe pranuar nga institucionet shtetërore. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 16.03.2021, la në fuqi vendimin e shkallës së parë. Në vendim, arsyetohet se prokuroria nuk ka zbatuar orientimet e vendimit të mëparshëm të Gjykatës së Apelit [me nr. {***}/2019], lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Lart, që urdhëronte kryerjen e aktit të ekspertimit grafik. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 01.02.2022.

14.9. Në datën 17.03.2022, subjekti urdhëroi *rifillimin* e hetimit paraprak të kësaj çështjeje dhe në datën 12.04.2022 urdhëroi OPGj-në për të kryer veprimet hetimore. Në vijim, në datën 21.04.2022 subjekti vendosi sekuestrimin e disa dokumenteve pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, për efekt të kryerjes së aktit të ekspertimit. Në datën 13.05.2022, OPGj-ja caktoi ekspertin dhe kryerjen e ekspertimit teknik. Në relacionin e datës 19.07.2022, për përfundimin e hetimeve të procedimit, OPGj-ja ka informuar subjektin se vendimi nr. {***}/1995, i KKKP-së Vlorë, rezulton i *falsifikuar*, pasi një prej nënshkrimeve nuk duhet të jetë i një prej anëtareve të Komisionit. Në datën 19.09.2022, subjekti urdhëroi kryerjen e disa veprimeve hetimore -- pyetjen e personave, plotësim i aktit të ekspertimit për të përcaktuar nëse nënshkrimet e ndodhura në vendimin nr. {***}/1995 janë nga i njëjti person, si dhe krahasimin e nënshkrimeve. Në relacionin e datës 19.07.2022, për përfundimin e hetimeve, OPGj-ja ka evidentuar përsëri se në vendimin nr. {***}/1995, nuk duhet të jetë nënshkrimi i njëjës anëtare. Në një relacion tjetër, të datës 13.03.2025, i njëjti oficer konstatonte se nuk ka elemente të falsifikimit të dokumenteve dhe sugjeroi që të paraqitet kërkesa për *pushimin* e çështjes penale. Konstatohet se ekspertimet janë kryer nga ekspertë të ndryshëm. Në datën 19.05.2025, një prokurore tjetër e çështjes ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak se ndjekja penale është *parashkuar*. Seanca paraprake është caktuar në datën 16.6.2025.

⁶⁶ Kjo dispozitë *parashikon*: Marrja e provave: 1. Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. 2. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos menjëherë, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë *haptazi të panevojshme*. 3. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të *parashikuara* nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria e provave ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

Në fashikullin e dërguar në Kolegj nuk administrohet informacion i mëtejshëm. Ndërkohë, subjekti ishte transferuar në Tiranë që nga qershori 2023.

14.10. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se transferimi i kësaj çështje nga Komisioni për inspektim në ILD, edhe në këtë rast, është tej afatit 5-vjeçar të parashkrimit, të përcaktuar në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016, që passjell shmangien e hetimit të shkeljes. Pa përsëritur sa është arsyetuar në paragrafin 13.11, për natyrën joserioze të shkeljeve, për të cilat Komisioni mund të disponojë me përcjelljen në ILD, edhe në këtë rast, konkluzioni i Komisionit është i pabazuar. Shkeljet që Komisioni konstatoi në rezultatet e hetimit janë të përsëritura dhe me pasoja për palët, që për shkak të mosveprimeve në vijimësi të subjektit, ndërsa flitet për veprime të ndodhura në vitin 2017, që sjellin për zbatim afatet prekluzive ligjore për hetim nga ILD e, për pasojë, shmangien e hetimit dhe pandëshkueshmërinë e veprimeve të subjektit.

14.11. Në momentin kur kryhej hetimi administrativ në Komision, kjo çështje i ishte kthyer për herë të dytë për plotësim hetimesh. Sikurse u analizua më lart, në kuptim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë që subjekti e mbylli dy herë çështjen, që u kthye nga Gjykata e Apelit për plotësim të hetimeve, trupi gjykues vlerëson se analiza në procesin e rivlerësimit përfshin veprimet e kryera më herët, për të cilat ka pasur zhvillime e qëndrime nga gjykatat, në periudhën 2015-2022, të përmbledhura e sjella në vëmendje më sipër.

14.12. Nga ana tjetër, pasi vendimi i gjykatës mori formë të prerë, nga data 20.05.2020 kur subjekti urdhëroi *regjistrimin* e procedimit penal deri kur subjekti kërkoi pushimin e çështjes gjashtë muaj më vonë [në datën 27.11.2020], *nuk* rezultojnë të jenë kryer veprime hetimore. Kjo nënkupton që praktikisht, subjekti ka regjistruar procedimin vetëm për formë, për të krijuar përshtypjen se ka një ndryshim me situatën e mëparshme kur ishte kërkuar mosfillim. Subjekti nuk zbatoi as urdhërimet e gjykatës që lidheshin me verifikimin e: (i) ekzistencës së dosjes përkatëse pranë institucionit që administronte aktet e ish-KKKP-së Vlorë; (ii) verifikimit të elementeve grafikë të pretenduar nga kallëzuesi, duke krahasuar këtë vendim (nr. {***}/1995) me vendime të të njëjtës periudhë; dhe (iii) kryerjen e ekspertimit grafik. Ndërkohë, emri i personit që i atribuohet vepra penale nuk ishte shënuar në regjistër. Po ashtu, kërkesa nuk parashtron analizë të akteve apo të figurës së veprës penale, duke u mjaftuar me argumentin se fakti nuk parashikohet në ligj si vepër penale. Në përgjigjet e rezultateve të hetimit, në kushtet që u konstatua mungesë hetimesh e kthim dy herë nga Gjykata e Apelit, për plotësim veprimesh, subjekti zgjodhi ta atribuojë përgjegjësinë gjetkë, duke u shprehur se *“duhet të vlerësohet sjellja e prokurorit të apelit që kërkoi ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për plotësim të hetimeve”*.

14.13. Sa më sipër, tregon që subjekti nuk zbatoi detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit, në mënyrë të përsëritur, ndërsa në vendim nuk rezulton një arsyetim se përse edhe pasi u urdhërua të kryhej ekspertimi grafik vazhdonte të ishte objektivisht i bazuar qëndrimi i saj i mëhershëm se ekspertimi *do të përbënte provë haptazi të panevojshme*, meqenëse, sipas saj, *dokumenti që pretendohet i falsifikuar është pohuar dhe pranuar nga vetë institucionet shtetërore*. Edhe dispozita me natyrë tërësisht procedurale e cituar prej saj si bazë, neni 151 i Kodit të Procedurës Penale, normon parimin e referuar si *fruti i pemës së ndaluar* – rregullat nëpërmjet të cilave përjashtohen provat e marra në mënyrë të paligjshme. Qartazi, ky parim nuk gjente zbatim në rastin konkret, mbi të gjitha në kushtet që tashmë kishte edhe një urdhërim konkret të gjykatës, bazuar në një dispozitë ligjore që ia njeht

këtë tagër – pika 1 e nenit 332/ç⁶⁷ të Kodit të Procedurës Penale, përcakton se është gjykata ajo që i deklaron provat të pavlefshme apo të papërdorshme, sipas rastit.

14.14. *Së fundmi*, nga aktet në dosje, konstatohet se kërkesa e subjektit për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2020, është e datës 27.11.2020, ndërsa personat e interesuar janë njoftuar në datën 22.12.2020, 27 ditë më vonë, në shkelje të afatit pesë (5) ditor të përcaktuar nga ligji⁶⁸. Edhe në këtë aspekt, subjekti nuk zbatoi afatet e përcaktuara në Kod për të njoftuar palën e interesuar, në mënyrë që të njihet me akte apo të paraqesë ankimin kundër kësaj kërkesë pa vonesa [në kuadër të procesit të rregullt ligjor].

14.15. Pretendimi i Komisioneres Publike se urdhri për regjistrimin e procedimit penal në fjalë, nxjerrë në datën 20.05.2020, përbën vonesë, nuk mbështetet nga aktet. Nga të dhënat e pasqyruara në fashikull, rezulton se vendimi i shkallës së parë ka marrë formë të prerë në datën 08.05.2020⁶⁹ dhe është dërguar në prokurori vetëm në datën 13.05.2020. Nga kjo përlllogaritje, rezulton se subjekti ka nisur procedimin përreth një javë pasi mori dosjen. Po ashtu, është i pabazuar në aktet në fashikuj edhe pretendimi tjetër i Komisioneres se subjekti ka urdhëruar rifillimin e hetimit me vonesë prej gati një vit, pasi ka marrë vendimin e dytë Gjykata e Apelit. Nga të dhënat në fashikuj rezulton se për shkak të kohëzgjatjes së qëndrimit të dosjeve në gjykatë përpara dërgimit në prokurori, subjekti ka urdhëruar rifillimin e hetimit më datë 17.03.2022, ndërsa Gjykata e Apelit ka konfirmuar vendimin e shkallës së parë më 16.03.2021, vendimit i është vënë shënim për marrje formë të prerë vetëm në datën 01.02.2022, ndërsa shkresa përcjellëse në prokurori mban datën 10.03.2022 ose shtatë (7) ditë përpara vendimmarrjes së subjektit.

14.16. Në përmbledhje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur dy ankime kundër vendimeve të gjykatës që në vijimësi nuk i zbatonte qoftë për veprimet që duheshin kryer, ashtu edhe për afatin – për kryerjen e aktit të ekspertimit ishte caktuar afat 2-mujor. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kallëzimi i vitit 2015 nuk kishte marrë ende një përgjigje më së paku deri në vitin 2022, për shkak të moskryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore, përfshirë edhe pasi u urdhërua nga gjykata, e çeljes së hetimit vetëm për formë, në më së paku një nga periudhat e ndërmjetme. Në këtë periudhë kohore, procedimi penal ishte regjistruar në vitin 2019 e *tre vjet* më pas, në vitin 2022, ishte ende pa zgjidhje. Ndonëse i janë specifikuar nga gjykata veprimet që duhet të kryheshin si parakusht për pushimin e procedimit që në vitin 2019, subjekti ka zgjedhur e insistuar të mos i kryejë, duke zgjedhur ankimet si qëllim në vetvete, pavarësisht se i ishte ofruar edhe një orientim për nevojat që duhet të përmbushte hetimi. Të tilla qasje të përsëritura nuk mund të mos analizohen nën optikën e drejtësisë që duke u vonuar, bëhet e munguar, nën dritën e nenit 6/1 të KEDNJ-së dhe të nenit 42 të Kushtetutës për proces të rregullt ligjor.

14.17. Këto konkluzione u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues si elemente për t'u vlerësuar në drejtim të aftësisë së subjektit për marrë urdhra dhe vendime, që së bashku me mungesën e analizës

⁶⁷ Neni 332/ç, parashikon: “Vendimi për plotësimin e hetimeve: 1. Kur çmon se hetimet paraprake nuk janë të plota, gjykata urdhëron plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtësinë dhe, kur është rasti, edhe aktet që duhet të kryhen. Kur konstaton akte të pavlefshme ose prova të papërdorshme, gjykata i deklaron ato me vendim dhe, kur është e mundur, urdhëron përsëritjen e tyre. Gjykata cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë dhe datën e seancës së re. 2. Vendimi i njoftohet drejtuesit të prokurorisë”.

⁶⁸ Neni 328, pika 2, parashikon: “Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t'u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”.

⁶⁹ Pasi është konfirmuar nga vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nr. {***}, datë 10.12.2019.

ligjore janë pjesë e indikatorëve nga të cilët deduktohen mangësi në drejtim të aftësive organizative të punës, sipas pikave 2 dhe 3⁷⁰ të nenit 73 dhe të nenit 74⁷¹ të ligjit nr. 96/2016, lexuar së bashku me Rregulloren e KLP-së [referuar më lart], që përmban orientime për mënyrën e vlerësimit të prokurorëve.

15. Procedimi penal nr. {***/2015

15.1. ILD-ja ka përcjellë në Komision një ankesë për subjektin e rivlerësimit, që lidhet me procedimin penal nr. {***/2015⁷² dhe një kallëzim penal të ushtruar nga dy individë kundër subjektit të rivlerësimit në datën 03.03.2020, për shpërdorim detyre nëpërmjet zvarritjes së hetimeve në procedimin penal objekt i kësaj analize, bazuar në kallëzimet e tyre. Në dokumentacionin e administruar në Kolegj, konstatohet se zanafilla e këtij procedimi është një kallëzim penal i datës 14.12.2015 i z. A. V. kundër një personi tjetër [z. L. B.] për falsifikim të dokumentacionit të një prone të trashëguar [me sipërfaqe 10.3 Ha] me vendndodhje në Jalë, Vuno, Vlorë. Në vijim, këtij procedimi i është bashkuar edhe procedimi penal i regjistruar për të njëjtin objekt në vitin 2016. Fokus është një konflikt pasuror/trashëgimor.

15.2. Pasi ka kryer hetim dhe ka konstatuar problematika të ngjashme me çështjet e tjera – kohëzgjatje kohore, mospërmbushje të detyrave të lëna nga gjykata dhe i ka kërkuar shpjegime subjektit, Komisioni ka konkluduar [si pjesë e rubrikës së të dhënave arkivore] që mangësitë e konstatuara janë të izoluara dhe në raport me ngarkesën në punë nuk çmohen si cilësi të papranueshme në punë apo si pjesë e një modeli sjelljeje të papranueshme apo në shkelje të të drejtave të palëve.

15.3. Komisionerja Publike argumenton se përfundimi i arritur nga Komisioni është rrjedhojë e një hetimi të mangët dhe i pambështetur në prova. Sipas saj, subjekti i rivlerësimit nuk dha përgjigje bindëse për ecurinë e procedimit penal dhe për detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin nr. {***}, datë 06.06.2018. Janë të paqarta veprimet procedurale të ndërmarra nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe nevoja e tyre e shtrirë në një kohë relativisht të gjatë, prej tetorit 2018 deri në datën 22.02.2022, kur ajo ka përpiluar kërkesën për pushimin e çështjes që tashmë ndodhet për shqyrtim në gjykatë. Në vlerësim të Komisioneres Publike, gjetjet në rastin e procedimit penal duhet të rivlerësohen nga Kolegji, ndërsa vlerësimi i filluar nga ILD-ja, marrë në zbatim të një kuadri tjetër ligjor, nuk mund të ndikojë apo zëvendësojë juridiksionin rivlerësues të Kolegjit, për qëllim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Gjatë seancës së zhvilluar në Kolegj dhe në bisedimet përfundimtare, edhe Drejtuesi i SPAK-ut i qëndroi të njëjtës linjë pretendimesh,

⁷⁰ “[2.] Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit. [...]”.

⁷¹ Neni 74, pika 4, parashikon: “[N]ë rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit. [...]”.

⁷² ILD-ja informoi edhe që është marrë vendimi i datës 14.04.2021, për verifikimin fillestar mbi statusin aktual të procedimit penal dhe verifikimin nëse z. A. V. ka paraqitur kallëzim ndaj subjektit pranë SPAK.

duke konstatuar ngjashëm me gjithë çështjet e sipëranalizuara për veprimtari hetimore të pamjaftueshme, konfirmuar edhe nga vendimet e gjykatave të të dy shkallëve.

15.4. Në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti bëri një ekspozitë të rrethanave të çështjes penale [ngjashëm me shpjegimet për gjithë çështjet e tjera], ndërsa i vetmi pretendim relevant për vonesat dhe mospërbushjen e detyrave ishte referencë te pamundësia e prokurorisë për të inspektuar veprimet materiale dhe që hetimi ka hasur probleme faktike për shkak të mungesës së fashikullit dhe moskthimit përgjigje të kërkesave dërguar Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti rezultoi të ketë mbajtur të njëjtën linjë prapësimesh, duke mosarsyetuar sesi ndodhitë e përmbledhura prej saj kanë afektuar veprimet hetimore dhe nëse qëndrojnë mangësitë e konstatuara.

15.5. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim i Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të SPAK-ut është i bazuar. Subjekti ka treguar mangësi të natyrës organizative në kryerjen e hetimeve në kohë, duke sjellë si pasojë cenimin e të drejtave të palëve. Për këto arsye, në të njëjtën linjë me arsyetimin e mësipërm, konstatimi i Komisionit është i pabazuar. Në analizën e vlerësimit profesional të subjektit duhet të ishte përfshirë edhe sa rezultoi nga mosveprimet e saj në këtë procedim penal. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

15.6. Në thelb, dy kallëzimet mbi bazën e të cilave janë nisur dy procedime penale të bashkuara eventualisht në një, janë një prokurë dhe një kontratë ndërmjetësimi të hartuara përpara të njëjtit noter⁷³. Kallëzuesit shprehen se i autorizuari, i kallëzuarit, i ka mashtruar nëpërmjet shpërdorimit të besimit. Procedimet penale janë bashkuar në një të vetëm në vitin 2016, ndërsa procedimi i parë u regjistrua në datën 16.12.2015, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Kallëzuesi pretendoi se nëpërmjet falsifikimit të nënshkrimit të tij dhe të nënës së tij në prokurën e përgjithshme, u shit prona e trashëguar dhe e fituar me vendim të KKK Pronave Vlorë. Në datën 26.04.2016, është regjistruar procedimi i dytë [nr. {***}] për të njëjtën veprë penale, me kallëzimin e një personi tjetër [z. V. A.], me pretendimin se nënshkrimi i tij në kontratën e ndërmjetësimit është falsifikuar. Pas disa zhvillimeve procedurale, Gjykata e Apelit Vlorë në datën 06.06.2018 ka urdhëruar rifillimin e procedimit penal të bashkuar dhe disa veprime specifike, nëpërmjet të cilave do të sqaroheshin rrethanat e fakteve të pretenduara, në ankim, për nëse prokura e vitit 2008 është e falsifikuar dhe nëse i kallëzuarit ka përdorur atë dhe nëse ai ka kryer edhe veprën penale të mashtrimit.

15.7. Pasi u kthye çështja në prokurori, dosja iu shortua subjektit në datën 03.09.2018. Subjekti ka nxjerrë urdhrin për rifillimin e hetimit paraprak për veprën penale të falsifikimit, ndërsa ka nxjerrë urdhrë për kryerjen e veprimeve hetimore vetëm në janar 2020 – pas 15 muajsh -- dhe në tetor e nëntor 2020 – 24 dhe 25 muaj më pas – në tetor 2020 dhe në nëntor 2020, përkatësisht, mori të dhëna nga kallëzuesi/personi që ka dijëni për veprën penale dhe administroi akte zyrtare [certifikatë të vdekjes së disa trashëgimtarëve] dhe mori në pyetje të kallëzuarin. Në pyetje u morën edhe disa noterë pranë të cilëve ishin kryer veprime të kalimit të pronësisë me prokurën joorigjinale, në janar dhe maj të vitit 2021 – thuajse dy vjet e gjysmë nga rifillimi i hetimeve. Tre vjet më pas, në datën 20.10.2021, subjekti mori vendim për kryerjen e dokumenteve dhe delegimin e veprimeve tek OPGJ.

⁷³ Në datën 15.12.2008, pranë noterit A. Xh. është lëshuar një prokurë e përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., nëpërmjet së cilës, z. E. B., z. S. B. dhe znj. K. B. [i besuar i të cilëve u paraqit z. V. A.], znj. B. B. dhe znj. L. B. [i besuar i të cilave u paraqitur z. A. V.], znj. Sh. A. [e besuar e së cilës u paraqit znj. N. V.] dhe z. Ll. R., kërkuan që z. L. B. t'i përfaqësojë me palë të treta dhe të hyjë në marrëveshje, të lidhë kontrata etj., në emër të tyre; kontrata e ndërmjetësimit, me nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 12.09.2009, nëpërmjet së cilës, është tjetërsuar një pasuri me sipërfaqe 34.000 m² që ishte në emër të z. A. V..

Ky i fundit, në datën 03.11.2021, mbajti procesverbalin e këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve te noteri [z. A. Xh.]. Pas përfundimit të hetimeve, në datën 09.02.2022, OPGj-ja ka sugjeruar se nuk u provua përtej çdo dyshimi se prokura është e falsifikuar dhe çështja duhet të pushohet. Në datën 22.02.2022, subjekti paraqiti përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesën për pushimin e çështjes. Në këtë kërkesë, subjekti analizoi se nuk u gjend prokura origjinale dhe, për pasojë, nuk mund të kryhet ekspertimi grafik i dokumentit me qëllim përcaktimin e nënshkrimit të pretenduar si të falsifikuar.

15.8. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti në këtë çështje ka treguar zvarritje të spikatura, edhe krahasuar me vonesat e arsytuara më sipër. Për këto arsye, konstatimi Komisionit për mangësi që i atribuohen ngarkesës në punë apo të natyrës joserioze është i pabazuar. Duke mbajtur në konsideratë sa është analizuar më sipër për ngarkesën në punë të subjektit, krahasuar me prokurorë të tjerë, në kushtet që subjekti ka rezultuar me ngarkesë më të lartë duke nisur nga viti 2021, konkluzioni i Komisionit është i pakuptimtë për vitet 2018-2021. Kërkesa e subjektit për pushimin e çështjes është marrë pas dy vjet e tre muajsh, në kundërshtim me nenin 329 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilit afati maksimal i hetimeve nga tre muaj deri *dy vjet*. Gjithashtu, subjekti nuk rezulton të ketë hartuar e përfshirë në dosje asnjë urdhër të zgjatjes së hetimeve përgjatë kësaj periudhe, përpos mungesës së shpjegimit për kohëzgjatjen, duke passjellë zvarritje të pajustificuar të procesit hetimor e, për pasojë, edhe të atij gjyqësor⁷⁴. Mënyra e interpretimit të saj se garancitë konventore për gjykim në kohë të arsyeshme mbrojnë vetëm të pandehurin është i pakuptimtë dhe u vlerësua në drejtim të aftësisë së subjektit për të interpretuar ligjin dhe aftësi organizative për përmbylljen e hetimit brenda afatit, sipas nënindiktorit të pikave 2 dhe 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

15.9. Përpos sa u analizua më lartë, në zbatim të rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Kushtetuese⁷⁵ dhe Gjykata e Lartë kanë një jurisprudencë të gjerë në të cilën është vënë theksi se *pajtueshmëria me kërkesat e një gjykimi të drejtë duhet të shqyrtohet në çdo rast që kanë lidhje me zhvillimin e procedurës në tërësi, dhe jo në bazë të një të izoluar shqyrtimi i një aspekti të veçantë ose një incidenti të veçantë*⁷⁶. Pra procedurat gjyqësore vlerësohen në tërësinë e tyre dhe jo të izoluar nga rasti në rast apo nga faza në të cilën ndodhen⁷⁷. Për këtë arsye, koncepti mbi të cilin subjekti vendos zbatimin e afatit të arsyeshëm, duke e lidhur me autorin e veprës penale, është i cunguar dhe i pasaktë, pasi anashkalon të drejtat e viktimave në proces dhe interesin publik.

15.10. Për nga thelbi i mënyrës së kryerjes së hetimit, kërkesa e subjektit për pushimin e çështjes deri në faqen 9 duket se përshkruan veprimet hetimore të kryera nga prokurori tjetër [z. A. M.] dhe

⁷⁴ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr. 6/2024, paragrafët 28-29.

⁷⁵ Shih, ndër të tjerë, edhe vendimin e sipërreferuar të Gjykatës Kushtetuese nr. 6/2024 për procedurën e hetimeve paraprake dhe afatet e arsyeshme.

⁷⁶ Guida e GjENDj-së për zbatimin e nenit 6 të KEDNJ-së në procesin penal:

https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_6_criminal_eng

⁷⁷ “Kështu, për shembull, në kontekstin e vlerësimit të procedurës së gjyqtarit të procedurës paraprake që konfirmon aktakuzën, Gjykata ka theksuar se duhet të ketë parasysh procedurat në tërësi, duke vlerësuar trajtimin e çështjes nga gjyqtari i procedurës paraprake në dritën e gjykimit pasues, kur përcaktohet nëse të drejtat e kërkuarit ishin cenuar. Si pjesë e për këtë përcaktim, duhet të vlerësohet nëse është marrë ndonjë masë gjatë procedurës përpara gjyqtarit të procedurës paraprake dobësoi pozitën e kërkuarit në atë masë sa që të gjitha të mëvonshme fazat e procesit ishin të padrejta”. Shih, ndër të tjera, çështjen që i përket vendimit të GJEDNJ-së, në rastin e Alexandru-Radu Luca kundër Rumanisë, § 63: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-217715%22%5D%7D> dhe Dvorski kundër Kroacisë, 2015, § 76: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-158266>

të gjykatave. Analiza e subjektit për faktet në lidhje me ligjin është gjysmë faqeje, nga 10 faqe në total të kërkesës. Në këtë analizë nuk vërehet arsyetimi për detyrat e lëna nga gjykata apo konkluzionet e arritura nga pyetja e kallëzuesit. Po ashtu, ndërsa subjekti referon se janë pyetur personat që la si detyrë Gjykata e Apelit [përfituesit e pronës], në fashikull nuk ka akte të dokumentimit të pyetjes, sikurse as veprime hetimore të tjera nuk janë pjesë e dosjes. Subjekti referon se administroi dokumentacion tjetër, i cili nuk duket të jetë pjesë e fashikullit⁷⁸. Të dhënat që subjekti referon në kërkesën e pushimit nuk përmbajnë data, në mënyrë që të mund të verifikohet kohështrirja e veprimeve hetimore të saj. Me rëndësi në këtë rast paraqitet edhe fakti se pavarësisht orientimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, rreth hetimit në drejtim të veprës penale të mashtrimit, subjekti nuk kreu asnjë analizë dhe nuk shprehet përse nuk hetoi për këtë vepër penale, në kohën kur konstatoi që paratë janë marrë në dorë/cash nga i kallëzuari. Subjekti nuk shpjegoi nëse i kallëzuari ua ka dhënë paratë shitësve që ai përfaqësonte, sikurse orientoi Gjykata e Apelit. Pra, subjekti nuk ka zbatuar orientimet e gjykatës në përfundimin e hetimeve të saj, në konsideratë këtu edhe sipërfaqen e madhe prej 10 ha tokë apo vendndodhjen strategjike të pronës në Jalë/Vuno.

15.11. Për sa më lart, pretendimet e Komisioneres Publike se subjekti ka treguar mangësi në hetime janë të drejta. Subjekti nuk ka respektuar afatet e hetimeve paraprake, që u vlerësuan sipas nënindikatorëve të nenit 71-73 të ligjit nr. 96/2016. Kallëzimi penal është drejtuar me emra konkret personash, shënimin në regjistër të emrave të të cilëve, subjekti nuk mund ta anashkalojë për të shmangur respektimin e afatet e hetimeve paraprake. Shkeljet në mënyrë të përsëritur të afateve, duke shmangur regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues si elemente që tregojnë mangësi të theksuara të subjektit në drejtim të aftësive profesionale.

16. Në vijim të sa më sipër, u vlerësuan të drejta pretendimet e Komisioneres Publike dhe ato të parashtruara nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, sipas së cilës vonesat, zvarritjet apo mospërfillja *de plano* e problematikave të ngritura në disa prej kallëzimeve penale rast pas rasti, që tentojnë t'i atribuohen edhe prioritetit në hetime të tjera, nuk u gjetën bindëse, por justifikuese dhe jo të arsyeshme në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit. Në kushtet që sikurse referuar më sipër, në disa raste, subjekti në mënyrë të pashpjegueshme e të paarsyetuar ka zgjedhur të mosrespektojë urdhërime të qarta e konkrete nga gjykatat, ka cenuar të drejtat e palëve të përfshira apo që kishin interes mbi ecurinë e hetimit penal dhe përfundimeve të pritshme prej tij, brenda afateve të arsyeshme, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNj-së.
17. Mangësitë e sipërreferuara paraqiten kryesisht në zbatimin e normave procedurale. Nën dritën e kriterëve të kontrollit, që përcakton neni 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duke u fokusuar vetëm te mangësitë në zbatimin e parimeve themelore të procesit të hetimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, sikurse referuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, subjekti i rivlerësimi ka shfaqur një *modus operandi* që karakterizohet nga një nivel i dobët i zbatimit të normave procedurale.
18. Në ndryshim nga konkluzioni i Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se pavarësisht se mangësitë e konstatuara nuk janë të atilla që passjellin shkarkimin nga detyra, duke qenë të përsëritura dhe mjaftueshëm tregues të një qasjeje që karakterizohet nga mangësitë në veprime e në interpretimin e ligjit nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të mos shoqërohen me reflektim të sa sipërkonstatuar pas shqyrtimit të kryer nga Kolegji, në kuadër të procesit të rivlerësimit të saj. Për

⁷⁸ Si shembull, dokumentacioni bankar, dokumentacioni nga ASHK-ja për të verifikuar shitjet apo nëse ka kontrata pjesëtimi, dhe as pyetja e noterit, z. A. Xh., nuk është bërë pjesë e fashikullit.

rrjedhojë, në zbatim të parashikimit të nenit 44, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 44, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në kushtet që subjekti i rivlerësimit vlerësohet “me mangësi”, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, brenda një viti, vendimi nr. 538, datë 07.06.2022, i Komisionit, duhet të ndryshohet dhe të jepet masa disiplinore e pezullimit nga detyra, e parashikuar në nenin 58, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenet 44, germa “b” dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 538, datë 07.06.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Alvora.
2. Pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Alvora, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
3. Ky vendim ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 16.07.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi